



RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në “Studime Mjedisore”

Universiteti POLIS

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm: Prof. As. Gafur Muka

PhD Elvan Dajko



(Janar/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc Studime Mjedisore

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "POLIS"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban
3	Urdhri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr 406, dt 26.05.2010
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	UMASH Nr 250, dt 14.06.2013 VKA Nr 470, dt 03.05.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Studime Mjedisore"
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Vetëm nga Universiteti POLIS
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Vetëm nga Universiteti POLIS
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
16	Aktivizimi i programit të studimit	UMAS Nr 557, dt 09.12.2010
17	Numri i studentëve	33 studentë
	etj	

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në “Studime Mjedisore”

Programi i Studimit Bachelor në “Studime Mjedisore” është licensuar nga Këshilli i Ministrave me VKM, Nr. 406, datë 26.05.2010, “Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private Universiteti POLIS, Tiranë” dhe më tej programi ka marrë lejen e ushtrimit të aktivitetit akademik me Urdher të MASH nr. 557, datë 09.12.2010 “Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit shkollës së lartë Private POLIS”.

Ky program i është nënshtruar akreditimit fillestar në vitin 2013, proces i finalizuar me Urdhër të MASH, Nr. 250, datë 14.06.2013 “Për akreditimin e programeve të studimit që përfundojnë me diplomat universitare “Bachelor”, “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” të Universitetit POLIS”, në përputhje me Vendimin Nr. 470, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Njësia Bazë (Kryesore) është Departamenti i Mjedisit pranë Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, miratuar me Vendim Senati, Nr. 1 date 12.09.2016.

Programi Bachelor në Studime Mjedisore është një program i ciklit të pare i cili konsiston në 180 ECTS, dhe ka kohëzgjatje normale tre vjet me kohë të plotë në përfundim të të cilit lëshohet diploma me emërtimin: “BACHELOR NË STUDIME MJEDISORE”.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. As. Gafur Muka
PhD Elvan Dajko

Menaxhere teknike e ndjekjes së kësaj procedure është Specialistia e SPVC, Znj. Suela Kromidha.

Më datë 16.01.2019, nëpërmjet sistemit AMS është dërguar në U Polis Draft RVJ. Universiteti Polis më datë 18.01.2019 kthen përgjigje për këtë Draft duke mos patur asnjë koment apo sugjerim. Për këtë arsye, raporti merr formën e tij përfundimtare dhe firmoset nga Ekspertët e vlerësimit.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- Të rritet numri i personelit akademik të punësuar me kohë të plotë në mënyrë që të plotësohet kriteri i vendosur prej 70% për stafin e angazhuar për realizimin e programit.
- Të përfundojë sa më shpejt puna për pasurimin e laboratorit të posaçëm të emërtuar: "Laboratori Sust_lab"
- Të përmirësohen për çdo lëndë disa nga syllabuset me elementët që duhet të përmbajnë përcaktuar nga aktet nenligjore.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin e pikës a, që në vitin pasardhës ky raport u përmirësua duke kaluar në një raport staf efektiv/staf me kontratë 79.4% me 20.6%. Aktualisht ky raport staf efektiv/staf me kontratë është 70.4% me 29.6% ose 19 staf akademik efektiv dhe 8 me kontratë.
- b) Për rekomandimin e pikës b, Universiteti POLIS, në përputhje me Objektivat e Hartimit të Programeve të Studimit si dhe të Zbatimit të Programit të Studimit të shprehur në Strategjinë e Brendshme Afatmesëm dhe Afatgjatë të Strategjisë së Zhvillimit të Universitetit POLIS, duke synuar pasurimin e vazhdueshëm të laboratorëve me pajisje dhe teknologji të reja, Universiteti ka investuar vazhdimisht në fuqizimin e Laboratorit për Mjedisin. Nga verifikimet dhe vizitat e bëra nga GVJ, rezulton që Laboratori është i pajisur me një shumëllojshmëri pajisjesh bashkëkohore dhe të cilësisë së lartë duke plotësuar dhe tejkaluar nevojat bazë që ka Programi Bachelor në Studime Mjedisore.
- c) Për rekomandimin e pikës c, nga verifikimet e bëra nga GVJ të Syllabuseve të çdo moduli të ofruar në POLIS, konstatohet se ato hartohen në përputhje me aktet nënligjore dhe përmbajnë elementët si në vijim:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Si konkluzion, mund të themi që Universiteti POLIS ka plotësuar të gjitha rekomandimet të dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e parë.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Mbështetur në Raportin e Vlerësimit të brendshëm (për më tej RVB), por edhe në dokumentacionin e dërguar nga Universiteti Polis (për më tej UP), Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (për më tej GVJ) konstaton se programi i studimit Bachelor në Studime Mjedisore synon të japë njohuri formuese të përgjithshme bazë mbi çështje dhe fenomene mjedisore në nivel global dhe lokal. Duke qënë një program i ciklit të parë, objektivat formuese fokusohen në dhënie të studentëve një formim dhe ekspertizë me bazë të gjerë në studime mjedisore.

Ky program ofrohet nga Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, duke qënë kështu në përputhje të plotë me misionin e ekspozuar në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit. Programi Bachelor në Studime Mjedisore, është një program studimi me kohë të plotë dhe me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike me një total prej 180 ECTS. Çdo vit akademik, i ndarë në dy semestra, ka 60 kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Qëllimi i programit është ai i formimit të një eksperti me fokus, me bazë dhe spektër më të gjerë formimi, përtej aspekteve inxhinjerieke, dhe me një përjasje më ndërdisiplinare dhe një kuptim më të gjerë të fenomeneve sociale e politike në raport me çështjet e mjedisit. Programi është konceptuar si një alternativë ndryshe nga çfarë ofronte “tregu” i edukimit deri në atë moment. Programet eksistuese të ofruara nga institucione të tjera kanë një qasje shumë më tepër inxhinjerieke gjë e cila nuk evidentohet në këtë program.. Programi ofron një formim të kombinuar të aspekteve më teknike e inxhinjerieke me ato më sociale, ekonomike dhe politike.

Siç dhe është përshkruar në rregulloren e tij, programi ka tre kolona kryesore:

- *formimit në fushën sociale dhe politike në raport me çështjet e mjedisit (me lëndë si Edukimi Mjedisor; Legjislacion Mjedisor, etj),*
- *formimin në shkencat e mjedisit (me lëndë që trajtojnë Shkencat e Tokës, Mjedisin Akuatik, Klimatologjinë, VNM, Menaxhimi dhe Planifikimin Mjedisor), çka reflekton dhe mundësinë e formimit në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh*
- *formimi baze, inxhinjerieke dhe teknik (me lëndë si Matematika, Kimia, Hidraulikë, Toksilologji, Aplikime kompjuterike, etj.).*

Risia e këtij programi është pikërisht integrimi i gjerë i tre formimeve të mësipërme dhe prezantimi i aspektit të politikave në raport me çështjet e mjedisit. Nevoja për specialistë të tillë evidentohet dhe nga studimet e tregut të bëra enkas nga institucioni dhe për Bachelor në Studimet Mjedisore (GVJ i është dhënë dhe studimi “Studim mbi tregun në fushën e Mjedisit”), duke konfirmuar gjithashtu dhe hartimin dhe konsolidimin e këtij programi në përputhje me nevojat e tregut e në respekt të rregullores së programit dhe statutit të Universitetit.

Gjykojmë që formimi i marrë nga ky program, aftëson studentët për punësim në nivele të ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore, në sipërmarrje apo studio private konsulence dhe projektimi apo në NGO në fushën e mjedisit apo lidhur me të. Përsa më sipër, gjykojmë që programi është në përputhje me qëllimet dhe objektivat e vëna në themelimin e tij, me nevojat reale të tregut Shqiptar e Ndërkombëtar si dhe me vetë Statutin dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit POLIS.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Objektivat dhe Programi i Studimit Bachelor në Studime Mjedisore, bazuar në Rregulloren e vetë programit dhe në vëzhgimin e programit, janë të hartuar/zhvilluar në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit (Neni 2 dhe 3 të Statutit të Universitetit POLIS).</p> <p>Programi i studimit synon të japë njohuri formuese të përgjithshme bazë mbi çështje dhe fenomene mjedisore në nivel global dhe lokal. Duke qënë një program i ciklit të parë, objektivat formuese fokusohen në dhënien për studentët të një formimi dhe ekspertize me bazë të gjerë në studime mjedisore. Kjo përfaqëse, referuar dhe shpërndarjes së krediteve/ lëndëve ku afër 18% e krediteve japin një formim të përgjithshëm bazë dhe rreth 50% e krediteve lidhen me disiplina karakterizuese që lidhen me fushën, u mundëson studentëve pas përfundimit të programit alternativa të mjaftueshme për thellim dhe profilizim të mëtijshëm të tyre gjatë ciklit të dytë të studimeve në fusha specifike mjedisore si në Shqipëri apo jashtë saj.</p> <p>Bazuar në rregulloren e vetë programit dhe në statutin e Universitetit, programet hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës. Gjithashtu institucioni zhvillon dhe studime tregu për programe të veçanta studimi, si në rastin e vetë Bachelor në Studimet Mjedisore (GVJ i është dhënë dhe materiali “Studim mbi tregun në fushën e Mjedisit”, punuar nga Dr A. Manushaqe) apo inpute të rëndësishme që merren nga ZMSKK-Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimi i Karrierës. Programi konkret aftëson studentët për punësim në nivele të ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore. Këta të diplomuar mund të punësohen edhe në sipërmarrje apo studio private konsulence apo projektimi si dhe NGO në fushën e mjedisit apo lidhur me të.</p> <p>GVJ konstaton që këto pozicione pune janë në linjë me formimin që marrin studentët gjatë programit si dhe me kërkesën e tregut të punës bazuar në studimet e tregut.</p> <p>Sikurse vërehet dhe në Statutin apo Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit POLIS, nëpërmjet aktivitetit të tij shkencor, akademik apo projekteve të aplikuara, synohet dhënia e një kontributi në zhvillimin ekonomik në nivel rajonal dhe kombëtar.</p> <p>Sic dhe vihet re në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, një nga shtyllat dhe prioritetet kombëtare është “Rritja përmes Përdorimit të Qëndrueshëm të Burimeve & Zhvillimit Territorial (Menaxhimi i Integruar i Ujit, Energjia dhe Toka)”.</p> <p>Në Rregulloren e Programit shprehet që synimi i programit është ai i formimit të një specialisti me bazë të gjerë të mjedisit, çka GVJ-e vëren dhe nga larmishmëria e lëndëve dhe moduleve të programit.</p>

GVJ konkludon që programi është në përputhje të plotë me zhvillimin ekonomik të vendit.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;

Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;

Në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit evidentohet fakti që si mision ka krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijes me anë të mësimdhënies, veprimtarisë kërkimore-shkencore e inovacionit, si dhe shërbimeve në fushat e specializimit të tij e në rastin konkret në atë të shkencave mjedisore.

Programi Bachelor në Studime Mjedisore ofrohet nga Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, duke qenë kështu në përputhje të plotë me misionin e ekspozuar në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit.

Nga rregulloret dhe diskutimet gjatë vizitës me drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit përgjegjës, stafin, ZMSKK-Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimi i Karrierës, NJBSC Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe vëzhgimi i evolimit të programeve apo përmbajtjes së syllabuse, GVJ gjen që për këtë program ka përpjekje të vazhdueshme për konsolidim të mëtejshëm të kërkimit shkencor, metodave të mësimdhënies apo dhe aktiviteteve dhe projekteve zhvillimore të lidhur me të. Një përmirësim i dukshëm është vërejtur dhe në drejtim të fuqizimit dhe konsolidimit të ambjenteve mësimore e në veçanti Bibliotekës dhe Laboratoreve. Përsa më sipër, GVJ shprehet që programi është në përputhje me Objektivat e Hartimit të Programeve të Studimit si dhe të Zbatimit të Programit të Studimit të shprehur në Strategjinë e Brendshme Afatmesëm dhe Afatgjatë të Zhvillimit të Universitetit POLIS.

Në rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Studime Mjedisore theksohet që zhvillimi i programit vjen si një alternativë ndryshe nga çfare ofronte "tregu" i edukimit deri në atë moment. I ngritur mbi eksperiencën pozitive të deriatëhershme, por me qëllimin e formimit të një eksperti me fokus, me baze dhe spektër më të gjerë formimi, përtej vetëm aspekteve inxhinjerieke, dhe me një përjasje më ndërdisiplinare dhe një kuptim më të gjerë të fenomeneve sociale e politike në raport me çështjet e mjedisit.

Programi ofron një formim të kombinuar të aspekteve më teknike e inxhinjerieke me ato më sociale, ekonomike dhe politike. Në fakt, siç dhe është përshkruar në rregulloren e tij, programi ka tre kolona kryesore.

Siç dhe raportohet dhe nga RVB, programet e studimit në Universitetin POLIS, edhe pse të ndryshme, janë mjaft të ndërthurura me njëri-tjetrin pasi në thelb të gjitha kanë si fokus projektimin dhe menaxhimin në shkallë të ndryshme të ambjentit, qoftë ai urban, rural apo natyror. Kjo gjë ndihmon në shkëmbim, bashkëpunim, përjasje ndërdisiplinore duke stimuluar dhe simuluar situata reale të ndërveprimit profesional. Njëherazi kjo ndihmon dhe në mundësinë e thellimit dhe profilizimit të studimeve në ciklet më të larta studimi si Masterat Shkencor,

	<p>Masterat Profesionale apo dhe Doktoraturë, si brenda institucionit apo dhe jashtë tij.</p> <p>Në këte menyrë, GVJ konkludon qe, në linjë me Statutin dhe me Strategjisë e Zhvillimit të Universitetit, përmbushet mjaft mirë si objektivi për të formuar specialistë të lartë dhe shkencëtarë të rinj ashtu dhe krijimi i një identiteti të formimit akademik, kërkimor dhe profesional të institucionit.</p>
--	--

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- kërkesat e punëdhënësve;
- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

Në Statutin i Universitetit POLIS vërehet që si Vizion (Neni 2) është ai i ofrimit të ekselencës në edukimin e profesionistëve dhe kërkuesve shkencorë të aftë për të adresuar nevojat e tregut. Strategjitë kombëtare venë në fokus çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e qendrueshëm të burimeve natyrore, zhvillimin rural, menaxhimin e territorit, turizmin natyror e kështu me rradhë. Si pasojë, mund të thuhet që ky program studimi do plotësojë nevojat e tregut në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.

Institucioni zhvillon studime tregu për programe të veçanta studimi, në të cilat evidenton mundësitë e punësimit, kërkesat e punëdhënësve për profilizime dhe aftësime të veçanta si dhe analizon numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucione simotra.

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;

Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Programi i studimit Bsc në SM, ofruar nga Universiteti POLIS është në sintoni me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Konkluzionet e vlerësimit:

Në shqyrtimin tërësor të plotësisimit të standardeve/kritereve për këtë rubrikë, GVJ konkludon:

- Objektivat dhe Programi i Studimit Bachelor në Studime Mjedisore, bazuar në Rregulloren e vetë programit dhe në vëzhgimin e programit, janë hartuar/zhvilluar në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit.**
- Programi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit.**
- Programi është hartuar për t'iu përgjigjur tregut të punës në përputhje me nevojat e vendit dhe mbështetet në eksperiencat ndërkombëtare. Politikat dhe objektivat e programit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, në mënyrë që programi t'i mbështeti këto zhvillime duke përgatitur studentë të aftë për të kontribuar në fushat e specializimit të tyre.**
- Programi Bachelor në Studime Mjedisore ofrohet nga Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, në përputhje të plotë me misionin e ekspozuar në Strategjinë e Zhvillimit të**

institucionit, i cili është krijimi, transmetimi, zhvillimin dhe mbrojta e dijes me anë të mësimdhënies, veprimtarisë kërkimore-shkencore e inovacionit, si dhe shërbimeve në fushat e kompetencave të tij e në rastin konkret në atë të shkencave mjedisore

5. Programi ofron një formim të kombinuar të aspekteve më teknike e inxhinierike me ato më sociale, ekonomike dhe politike.
6. Strategjitë kombëtare në fushën mjedisore vënë fokusin në çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e qendrueshëm të burimeve natyrore, zhvillimin rural, menaxhimin e territorit, turizmin natyror e kështu me rradhë. Si pasojë, mund të thuhet që ky program studimi do plotësoj nevojat e tregut në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.
7. Programi i studimeve Bachelor në Studime Mjedisore është në sintoni me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

2. Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Struktura organizative e Universitetit POLIS përbëhet nga 4 (katër) lloje të njësive organizative dhe konkretisht:

- Njësi kryesore, që janë Fakultetet
- Njësi bazë, ku përfshihen departamentet dhe qendrat kërkimore
- Njësitë ndihmëse si laboratorë, studiot profesionale, etj.
- Qendra ndër-departamentale për Studime Ndërdisciplinore Kërkimore dhe Inovacioni.

Universiteti POLIS përbëhet nga 3 njësi kryesore (fakultete) dhe 9 njësi bazë (departamente) (3 për secilën njësi kryesore), nga të cilat 6 departamente me natyrë akademike dhe 3 njësi të dedikuara tërësisht për kërkim. Në përputhje me misionin dhe objektivat e veta, POLIS ka krijuar gjithashtu një qendër kërkimore ndërdisiplinare, përkatësisht Fabrika e Inovacionit (IF)

Me hyrjen në fuqi të ligjit 80/15 dhe miratimit nga ministria e arsimit të statutit në fuqi të Universitetit POLIS, njësia përgjegjëse për organizimin e programit Bachelor në Studime Mjedisore është Departamenti i Mjedisit pranë Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban (FPMMU)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Planifikimit, Mjedis dhe Menaxhim Urban ka në përbërje të tij 2 (dy) departamente përkatësisht: Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban (DPMU) dhe Departamenti i Mjedisit (DM) si dhe Qendrën Kërkimore të Qëndrueshmërisë (Sust_Lab).

Struktura e tij drejtuese dhe numri i stafit është si më poshtë:

FAKULTETI i PLANIFIKIMIT, MJEDISIT DHE MENAXHIMIT URBAN (FPMMU)

Dekan: Prof. Dr. Sh. Lushaj
Zv/dekan: Dr. D. Papa

Departamenti i Planifikimit dhe Menaxhimit Urban (DPMU)

Drejtues: Dr. G. Rëmbeci
Staf akademik efektiv: 9
Staf akademik me kontratë: 18

Departamenti i Mjedisit (DM)

Drejtuese: Prof. Asoc. E. Susaj
Staf akademik efektiv: 9
Staf akademik me kontratë: 7

Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë (Sust_Lab)

Drejtues: Dr. E. Canga
Staf akademik efektiv: 8

Bazuar në strukturën akademike, organigramën dhe të dhënat e stafit akademik, FPMMU ka aktualisht 51 pedagogë gjithsej, nga të cilët 26 janë staf akademik efektiv (brendshëm) dhe 25 staf akademik të ftuar (me kontratë). Stafi brendshëm përbëhet nga 9 pedagogë efektivë të DPMU, 9 pedagogë efektivë të DM dhe 8 të Njesisë kërkimore të qëndrueshmërisë.

Përsa i përket shkallës së kualifikimit të stafit akademik, ndër 51 gjithsej, 25 pedagogë mbajnë tituj ose grada. Nga 26 stafi brendshëm, 13 mbajnë tituj ose grada (50%) ndërsa nga stafi i ftuar të tillë janë 12 nga 25, d.m.th 48%. Raporti staf efektiv/staf me kontratë është 1.04:1. *(Për më shumë info, shiko në Aneks: Tabela 1. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat dhe Tabela 2. Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Staf i për vitin akademik 2018-2019)*

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Mjedisit, si njësi bazë ku zhvillohet programi Bachelor në Studime Mjedisore, për vitin akademik 2018-2019 ka në përbërje të tij 9 anëtarë efektivë si personel akademik (ndër të cilët 1 Prof. Dr., 1 Prof.Ass.Dr. dhe 3 Dr., si dhe 4 Dr. në proces) dhe 7 PAK (1 Dr; 1 Dr në proces; 5 Msc)

Në këtë kuptim departamenti plotëson standardet sa i përket numrit dhe kualifikimit të stafit. *(Për më shumë shiko Aneksin: Tabela 3. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat 2018/2019)*

Mbështetur në të dhënat e sjella me Dosjen e vetvlerësimit, Aneks/Shtojcë Organigrama e vitit akademik 2016/2017, Departamenti i mjedisit përbëhej nga 7 PAE (1 Prof. Dr; 1 Prof As; 1 Dr dhe 4 Dr në proces.

Ndërsa për vitin akademik 2017/2018, po sipas Aneks/Shtojcë Organigrama e vitit akademik 2017/2018, Departamenti i mjedisit përbëhej nga 7 PAE (1 Prof. Dr; 1 Prof As; 2 Dr; 3 Phd në proces)

Balanca gjinore gjithashtu është e ekuilibruar ku raporti M/F është 8/8 *(Për më shumë shih Aneksin: Tabela 4. Të dhënat e stafit akademik të përgjithshëm sipas gjinisë)*

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Ne shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton që ka një balancë mjaft të mirë ndërmjet stafit me eksperiencë dhe atij më të ri e shpesh të kualifikuar jashtë vendit, duke garantuar kështu një formim të plotë profesional dhe të përditësuar. Raporti pedagog efektiv / studentë për këtë program studimi është thujse 1:2, gjë që mundëson një punë intensive me secilin student individualisht duke kontribuar kështu në rritjen e cilësisë së edukimit që ata marrin. Bazuar në të dhënat statistikore për stafin akademik, CV-te e tyre, takimit të drejtpërdrejtë me to dhe feedback-ut të marrë nga takimi me studentët, GVJ gjykon se stafi i angazhuar në programin e studimit Bachelor në Studime Mjedisore ka kualifikimin e dhe përvojën e duhur për të garantuar një mësimdhënie cilësore dhe për të transmetuar tek studentët njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.

Nga verifikimet e bëra në Programin e Studimit Bachelor në Studime Mjedisore, personeli akademik total në këtë program është 27 persona, nga të cilët 19 janë staf akademik me kohë të plotë dhe 8 staf akademik me kohë të pjesshme. Bazuar në këto të dhëna, rezulton që stafi akademik me kohë të plotë përbën afërsisht 70.4% të personelit akademik total në këtë program. Ky fakt, përvec se respekton plotesimin e kushteve ligjore, plotëson dhe përmbush edhe rekomandimet e dhëna nga Bordi i Akreditimit në vendimin për akreditimin e mëparshëm të këtij Programi Studimi për rritjen e numrit të personelit akademik në 70%. *(Për më shumë detaje shiko në Aneks të raportit: Tabela 6. Staf i angazhuar në programin e studimit BSc në Studime Mjedisore gjatë vitit akademik 2018-2019)*

Për vitet akademike duke filluar nga viti 2012-2013 dhe deri në vitin aktual akademik 2018-2019 referuar të dhënavë të paraqitura në Dosjen e vetvlerësimit por edhe RVB, stafi akademik i programi jepet si më poshtë::

viti akademik 2012 - 2013; **21 PAE dhe 10 PAK**

21 PAE – 5 Prof. Dr; 2 Prof As; 2 Dr; 3 Dr në process; 3 MND dhe 6 MSC

10 PAK – 2 Prof Dr; 2 Prof As; 4 Dr; 2 Msc

viti akademik 2013 - 2014; **27 PAE dhe 7 PAK**

27 PAE -4 Prof. Dr; 1 Prof As; 6 Dr; 2 Dr në process; 4 MND; 10 Msc

7 PAK – 2 Prof. Dr; 1 Prof. As; 2 Dr; 1 Dr në process; 1 Msc

viti akademik 2014 - 2015; **21 PAE dhe 6 PAK**

21 PAE – 4 Prof. Dr; 1 Prof. As; 6 Dr; 2 Dr në process; 3 MND; 5 Msc

6 PAK – 1 Prof. Dr; 1 Dr; 4 Msc

viti akademik 2015 - 2016; **19 PAE dhe 8 PAK**

19 PAE - 4 Prof. Dr; 2 Prof. As; 8 Dr; 2 Dr në process; 1 MND; 2 Msc

8 PAK - 1 Prof. Dr; 1 Dr; 5 Msc; 1 Mp

viti akademik 2016 - 2017; **20 PAE dhe 6 PAK**

20 PAE - 5 Prof. Dr; 2 Prof. As; 7 Dr; 5 Dr në process; 1 Msc

6 PAK - 1 Prof. Dr; 2 Dr; 2 Msc; 1 Mp

vitit akademik 2017 - 2018; **16 PAE dhe 13 PAK**

16 PAE - 4 Prof. Dr; 1 Prof. As; 6 Dr; 5 Dr në process;

13 PAK - 1 Prof. Dr; 5 Dr; 1 Dr në process; 5 Msc; 1 Bsc

vitit akademik 2018 - 2019; **17 PAE dhe 8 PAK**

19 PAE - 3 Prof. Dr; 1 Prof. As; 7 Dr; 1 Doc; 7 Dr në process;

8 PAK - 1 Prof. Dr; 1 Dr; 1 Dr në process; 5 Msc;

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Nga stafi i angazhuar në programin e studimit, 4 janë me titull Prof. Dr., (në një raport PAE/PAK 3/1) 1 me titull Prof. Ass. Dr. (në një raport PAE/PAK 1/0), 1 me gradën shkencore Docent-Doktor (në një raport PAE/PAK 1/0), 8 me gradën shkencore Doktor (në një raport PAE/PAK 7/1), 8 në proces doktorature (në një raport PAE/PAK 7/1), dhe 5 me gradë shkencore MSc. (vetëm staf PAE, përgjithësisht asistentë dhe me ekspertizë në fushë). I gjithë personeli i angazhuar në mësimdhënie ka së paku kualifikimin e ciklit pasardhës, ndërkohë ajo që bie në sy është që stafi akademik efektiv i këtij programi është i gjithi i përfshirë në ciklin e tretë të studimeve dhe, ku rreth një e treta e tij kanë gradën Dr. Dhe, që në një periudhë relativisht të afërt, me plotësimin e kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, do të fitojnë titujt pasues akademik. *(Për më shumë detaje shiko në Aneks të raportit : Tabela 6.1. Staf i programit të studimit gjatë vitit akademik 2018-2019, të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre)*

Të dhënat sipas seksit

Vihet re që në shpërndarjen gjinore stafi i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Studime Mjedisore" ka një shpërndarje mjaft korrekte dhe të balancuar të ndarë thuajse përgjysëm, më konkretisht raporti F/M është 12/15. Staf i me gradën Prof. është totalisht i gjinisë mashkullore, ndërkohë që stafi me gradën Dr. anon më shumë nga gjinia femërore, çka nënkupton që me fitimin e titujve pasues akademik pritet dhe një ekuilibër gjinor me gradën Prof. *(Për më shumë detaje shiko në Aneks të raportit : Tabela 6.4. Staf gjatë vitit akademik 2018-2019 sipas gjinisë)*

Të dhëna sipas moshës së personelit

Vihet re që edhe në shpërndarjen moshore stafi i angazhuar në programin e studimit Bachelor në Studime Mjedisore ka një shpërndarje mjaft korrekte. Mbizotëron moshën e re dhe mesatare (25-55 vjeç) në një raport 13/6 për PAE dhe 7/1 për PAK.

(Për më shumë detaje shiko në Aneks të raportit : Tabela 6.2. Staf gjatë vitit akademik 2018-2019 sipas grupmoshës dhe Tabela 6.3. Staf i jashtëm gjatë vitit akademik 2018-2019 sipas grupmoshës)

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konsultoi dosje të rekrutimit të personelit si dhe dokumentacionin përkatës dhe konstatoi se rekrutimi i personelit akademik të profilit të propozuar vjen nga departamentet, të cilët parashtrajnë në terma reference të qarta duke përcaktuar detyrat e personelit të kërkuar dhe profilin e tij. Detyrat e përcaktuara në termat e referencës bazohen në përmbajtjen e lëndës që do të ofrojë pedagogu, natyrën e mësimdhënies si dhe matricën e njohurive dhe aftësive të transferuara tek studentët. Përcaktimi i qartë i rolit të pedagogut mundëson dhe hartimin e profilit të tij, fushën e studimeve, gradat/titujt akademikë, si dhe aktivitetin kërkimor që ai duhet të ketë.

Kontratat e punësimit të stafit, janë mbështetur në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sportit për ngarkesën mësimore të pedagogut, si dhe përputhen me Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit. Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe Universitetit POLIS. Kontratat janë në përputhshmëri me kuadrin ligjor në fuqi dhe rregullativ të institucionit dhe dosjet e personelit u gjeten të plota me gjithë dokumentacionet e kërkues nga ligji.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Gjatë vizitës në U-Polis u informuam se për sa i përket procedurës së lidhjes së kontratës së punës, për çdo anëtar të stafit administrativ dhe PAE apo PAK ndiqet një procedurë, e cila nis me procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes, informimit të personit për përzgjedhjen e tij për t'u marrë në punë pranë U_POLIS dhe, më pas, ai paraqitet dhe nënshkruan kontratën e punës e cila legalizon pozicionin e tij. Kontrata përfshin njohjen me detyrat dhe të drejtat e të dy palëve. Personit që rekrutohet i vihen në dispozicion të gjithë dokumentet e brendshme, statute, rregulloret dhe udhëzimet në mënyrë që ai të njihet në detaje me të drejtat dhe detyrimet e punës në institucion. Feedback-u i marrë nga stafi akademik në lidhje me atë ndihmës apo administrativ ka qënë pozitiv. E njëjta gjë u konfirmua dhe nga studentët gjatë takimit, kryesisht referuar stafit "teknik" si laborantët.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Perveç dokumentacionit në dispozicion në fillim të këtij vlerësimi, GVJ iu vunë në dispozicion dhe materiale nga dosjet e personelit (në forma anonime) si dëshmi të ndryshme, formularët e intervistës së rekrutimit, anekse kontratash, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimin të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimin të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Në dokumentat e dorëzuara nga Institucioni (dhe të miratuara zyrtarisht sipas të gjitha instancave ligjore) GVJ gjen që kriteret e rekrutimit janë të qarta dhe vërtetojnë ndjekjen e një procedure ligjore dhe transparente. Më konkretisht, kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit (Kreu IX) dhe Rregulloren e Përgjithshme të tij (kreu IV) si dhe nga një document përmbledhës me emërtim "Procedura dhe kriteret e rekrutimit të kandidatëve për personel i Universitetit Polis". Ndjekja dhe respektimi i këtyre procedurave është verifikuar drejtperdrejtë gjatë vizitës në Institucion në takimin me Drejtuesit e Njësive, me vetë Stafin Akademik dhe në takimin me Zyrën e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike ku janë kërkuar dhe parë dosjet dhe procesverbalet e rasteve konkrete të rekrutimit të stafit.</p> <p>Nga verifikimet e bëra prej GVJ në Programin e Studimit Bachelor në Studime Mjedisore, konstatohet personeli akademik total në këtë program është 27 persona, nga të cilët 19 janë staf akademik me kohë të plotë dhe 8 staf akademik me kohë të pjesshme. Bazuar në këto të dhëna, rezulton që stafi akademik me kohë të plotë përbën afërsisht 70.4% të personelit akademik total në këtë program. Ky fakt, përveç se respekton plotësimin e kushteve ligjore, plotëson dhe përmbush edhe rekomandimet e dhëna nga Bordi i Akreditimit në vendimin për akreditimin e mëparshëm të këtij Programi Studimi për rritjen e numrit të personelit akademik në 70%.</p> <p>GVJ konstaton qe procedurat e vlerësimin të performances së stafit akademik janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit (Kreu XI)</p>

	<p>dhe Rregulloren e Përgjithshme të tij (kreu XV) si edhe në rregulloren e NJBSC-së. Këto procedura janë verifikuar në mënyra të shumëfishta gjatë vizitës në institucion duke pyetur të gjitha palët e interesuara jatë takimit me Drejtuesit e Njësive, Stafin akademik, Studentët dhe NJBSC-në</p> <p>Vlerësimi bëhet në tre “dimensione”. Peshën më të madhe e ka vlerësimi i bërë nga ana e studentëve nëpërmjet pyetësorëve (zhvilluar nga NJBSC dhe të dokumentuara pranë kësaj njësie) të plotësuar në mënyrë anonime dhe online në fund të çdo semestri për secilin pedagog në lëndët përkatëse. Fokusi i pyetjeve është në marrjen e inputeve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, literaturës së përdorur dhe tregues të tjerë të lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Një komponent i dytë në vlerësim është ai i konsideruar si “mes të barabartëve”, pra që nënkupton vlerësimin nga ana e kolegëve mbi kriteret të ngjashme me po ato të vlerësimit nga ana e studentëve. Së fundmi vetë pedagogët plotësojnë një formular vetëvlerësimi, i cili ka peshë më të vogël në vlerësimin final.</p> <p>Një vlerësimi tjetër bëhet dhe nga përgjegjësit e departamenteve të cilët me anë të verifikimeve në ambjentet e mësimdhënies apo takimeve specifike vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies duke raportuar më tej pranë dekanatit.</p> <p>Gjatë vizitës në U_Polis GVJ verifikoi që pranë Zyrës së Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike Institucioni mban një bazë të dhënash dhe dosjet e gjithë personelit, ku përfshihen raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, njoftimet për vendet vakante, etj. Gjatë takimit me këtë njësi u panë dhe verifikuan raste konkrete që vërtetojnë respektimin e procedurave si dhe u konstatuan që intervistat zhvillohen nga një grup ad hoc sipas rregulloreve.</p>
--	--

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p>	<p>Universiteti POLIS disponon një bazë të dhënash të hollësishme për të gjithë stafin akademik, e cila është e arkivuar dhe e verifikuar nga vetë GVJ gjatë vizitës pranë Zyrës së Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike.</p> <p>Gjatë kësaj vizite dhe verifikimit të dosjeve personale të stafit akademike (janë kërkuar nga GVJ, në përzgjedhje rastësore nga ana e tij, disa dosje) rezultoi se në dosjet përmbahen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - CV - Dokumente identifikimi (Pasaportë ose ID) - Fotografi - Diplomë e noterizuar të studimeve universitare - Transkripti i noterizuar i lëndëve dhe notave të studimeve universitare.
<p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Diploma e noterizuar e Titullit Akademik (Prof., Prof. As., Dr, Docent) (kur aplikohet) - Diplomë e noterizuar e studimeve pasuniversitare (kur aplikohet) - Transkripti i noterizuar i lëndëve dhe notave të studimeve universitare (kur aplikohet)

	<ul style="list-style-type: none"> - Licencën Profesionale (kur aplikohet) - Certifikata apo dëshmi të ndryshme (kur ka) - Dëshmi penaliteti - Librezë Shëndetësore dhe Raport mjeko-ligjor <p>Zyra e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike disponon listen e plotë të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ së bashku me dokumentacionet e tyre përkatëse.</p> <p>Vendet vakante, së bashku me kriteret dhe kërkesat e tyre specifike, publikohen nga ana e Rektoratit, me kërkesë të Departamenteve përkatëse që i kanë zhvilluar në varësi të nevojave të tyre dhe konform Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të institucionit. Publikimi bëhet në faqen elektronike zyrtare të institucionit www.universitetipolis.edu.al, përhapet nëpërmjet kanalesh të tjera mediatike/online si dhe vihet në dijeni Shërbimi Kombëtar i Punës. Për më tepër procedura është konfirmuar dhe gjatë takimit me Stafin Akademik ku në disa raste gjatë prezantimit të pedagogëve është përmendur fakti i aplikimit pas shikimit të lajmërimeve online për vendet vakante.</p> <p>Drejtuesit e moduleve, në përgjithësi, kanë titullin Profesor. ose gradën Shkencore Doktor</p>
--	---

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Në dokumentacionet e dorëzuara nga Universiteti POLIS deklarohet që institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore. Ky fakt është verifikuar nga GVJ si në takimet me Stafin apo me Studentët dhe po ashtu gjatë fazës së vizitës në ambjentet e laboratorëve ku një pjesë ishte në atë moment në përdorim për kryerjen e praktikave laboratorike nën drejtimin e pedagogëve titullare të lëndës dhe me asistencë të stafit teknik/laborantëve. Gjithashtu është vërejtur që në ambjentet laboratorike kishte të afishuara rregulla për përdorimin si dhe vërehej një rregullsi dhe mirëmbajtje e shkëlqyer e ambienteve dhe pajisjeve.</p> <p>Institucioni dëshmon një angazhim shumë të mirë të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. Nga verifikimet e bëra, çdo pedagog ka një program të qartë, të mirëpërcaktuar e të balancuar, të dokumentuar në anekset e kontratave, ku përcaktohet angazhimi i tij në mësimdhënie, kërkimin shkencor dhe detyra administrative. Ky fakt ndihmon në një kontribut dhe angazhim të gjerë e gjithëpërfshirës të stafit por gjithashtu ndihmon në ekuilibrimin e mësimdhënies dhe kërkimit, çka stimulon një rritje të vazhdueshme të stafit e si pasojë të cilësisë së mësimdhënies. Nga vetë diskutimet që GVJ ka bërë me studentët, është evidentuar një vlerësim i gjërë ndaj stafit të universitetit, qoftë akademik, ndihmës mësimor-shkencor apo administrativ duke konfirmuar</p>
--	---

	<p>gatishmërine e tyre për të diskutuar për çfarëdo problematike që studentët mund të kenë.</p> <p>Nga verifikimet e bëra rezulton se në programin e Studimeve Bachelor në Studime Mjedisore ka aktualisht 33 studentë ndërkohë që stafi përbëhet nga 19 Staf Akademik Efektiv dhe 8 Staf Akademik me Kontratë, pra 27 pedagogë në total. Si pasojë, raporti pedagog / studentë për këtë program studimi është 1:1.3 (ose thajse 1:2 pedagog efektiv / studentë), çka garanton një ndërveprim dhe asistencë të gjerë ndaj studentëve duke rritur mundësite e një edukimi cilësor</p> <p>Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës informon dhe asiston studentët për gjetjen e mundësive për zhvillimin e praktikave profesionale. Ndërkohë që çdo studenti i caktohet një pedagog mbikëqyrës, i cili duhet të ndjeke ecurinë e praktikës mësimore, performanca e të cilit në fund vlerësohet nga një komision vlerësues.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtëjshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Në bazë të raportit të GVB, Univeriteti POLIS ka një politikë mbështetëse për kualifikimin e mëtëjshëm akademik dhe shkencor të stafit të tij.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik ka konfirmuar që institucioni inkurajon, mbështet dhe në disa raste financon personelin akademik për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme shkencore apo publikime.</p> <p>Mënyra të tjera të evidentuara që kontribuojnë në kualifikimin e mëtëjshëm profesional janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi dhe financimi i konferencave, seminareve apo aktiviteteve shkencore • Organizimi i vizitave studimore në institucione partnere. • Organizimi i shkëmbimeve akademike në kuadër të projekteve të kërkimit/zhvillimit. • Trajnime dhe seminare në kuadër të projekteve të ndryshme kërkimi/zhvillimi. • OJT (on the job trainings) ne kuader të projekteve të ndryshme kërkimi/zhvillimi. • Angazhimi në projekte konkrete kërkimi/zhvillimi/te aplikuar. <p>Gjithashtu është konfirmuar si nga drejtuesit e njëjve dhe vetë stafi i ri që këta të fundit inkurajohen për të nisur ciklin e tretë të studimeve (PhD). Kjo është e faktuar me një numër të konsiderueshëm të stafit të ri (11 nga Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban përgjegjës për Bachelor) që janë duke zhvilluar studimet e Doktoraturës dhe angazhimi i tyre në institucion është rregulluar me marveshje specifike si përgjatë studimeve dhe pas përfundimit të tyre.</p> <p>Institucioni ka nja bazë të dhënash të plota ta programeve të ofruara.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Nga shqyrtimi tërësor i plotësimit të standardeve/kritereve në rubrikat 2 dhe 3, GVJ konkludon:

1. Kriteret e rekrutimit janë të qarta dhe vërtetojnë ndjekjen e një procedure ligjore dhe transparente.
2. Aktualisht, Stafit akademik me kohë të plotë përbën afërsisht 70.4% të personelit akademik total në këtë program.
3. Procedurat e vlerësimit të performances së stafit akademik janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit (Kreu XI) dhe Rregulloren e Përgjithshme të tij (kreu XV) si edhe në rregulloren e NJBSC-së. Këto procedura janë verifikuar në mënyra të shumëfishta gjatë vizitës në institucion dhe janë ligjore dhe transparente.
4. Institucioni mban pranë Zyrës së Burimeve Njerezore dhe Cështjeve Juridike një bazë të dhënash dhe dosjet e gjithë personelit, ku përfshihen raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, njoftimet për vendet vakante, etj
5. Universiteti POLIS disponon një bazë të dhënash të hollësishme për të gjithë stafin akademik, e cila është e arkivuar.
6. Zyra e Burimeve Njerezore dhe Cështjeve Juridike disponon listen e të plotë të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrative së bashku me dokumentacionet e tyre përkatëse dhe, në plotësim të kuadrit ligjor në fuqi.
7. Vendet vakante për personel, së bashku me kriteret dhe kërkesat e tyre specifike, publikohen nga ana e Rektoratit konform Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të institucionit.
8. Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore.
9. Institucioni dëshmon një angazhim të mirë të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. Nga verifikimet e bëra, çdo pedagog ka një program të qarte, të mirëpërcaktuar e të balancuar, të dokumentuar në anekset e kontratave, ku përcaktohet angazhimi i tij në mësimdhënie, kërkimin shkencor dhe detyra administrative.
10. Në programin Bachelor në Studime Mjedisore, raporti pedagog / studentë për këtë program studimi është 1:1.3 (ose thuhet 1:2 pedagog efektiv / studentë), çka garanton një udhëheqje dhe mbikëqyrje optimale të studentëve në praktikën profesionale si dhe një ndërveprim dhe asistencë të gjerë ndaj studentëve duke rritur mundësitë e një edukimi cilësor
11. Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. Kjo vërtetohet gjerësisht me trajnimet që i bëhen stafit, si dhe nga Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" apo programet e ciklit të tretë Doktoraturë, ku stafi i ri nxitet të marrë pjesë. GVJ konstaton që institucioni inkurajon, mbështet dhe, në shumë raste financon personelin akademik për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme shkencore apo publikime që nxisin dhe kualifikimin e tij.
12. Institucioni ka një bazë të dhënash të plotë të programeve të ofruara.

4. **Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

GVJ vizitoi ambientet e universitetit si klasat, auditorët, laboratorët, sallat e studimit, bibliotekën por dhe hapësirat e tjera të përbashkëta të studentëve, të cilat përdoren për studim, punë praktike apo argëtim. Të gjitha ambientet mund të konsiderohen bashkëkohore dhe që plotësojnë më së miri nevojat e studentëve. Gjithashtu u konstatua se kishte hapësira të mjaftueshme për stafin akademik por dhe atë administrativ, të pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për kryerjen e kërkimeve akademike, shkencore dhe të aplikuar. Ambientet e institucionit janë të shumëllojshme dhe me karakteristika specifike në varësi të përdorimit që kanë. Klasat janë të gjitha të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (kompjuter, videoprojektor, etj.) duke lehtësuar mundësinë e një mësimdhënie cilësore. Auditorët gjithashtu janë të pajisura me kompjutera dhe sisteme audio e video çka ndihmon në mënyrë optimale jo vetëm zhvillimin e mësimin por dhe aktivitetet e tjera si seminare, konferenca, etj. Ndërkohë në institucion ka të pranishme hapësira të tjera si zyra, studio, salla mbledhjesh e takimesh, hapësira për studim jashtë mësimin, galeri ekspozimi, etj., të cilat janë të gjitha të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Në të gjitha hapësirat e institucionit është e mundur aksesin në internet nëpërmjet rrjetit ëi-fi.

GVJ verifikoi që në institucion gjenden një sërë laboratorësh si:

1. Laboratori i Mjedisit
2. Laboratori i GIS/CAD/SAP/ETABS/TEKLA
3. Laboratori i Eficiencës Energjitime
4. Laboratori i Prototipizimit
5. Laboratori i MAC
6. Laboratori i Qeramikës
7. Laboratori i Fotografisë
8. Laboratori i Pikturës

Institucioni ka një bibliotekë me një fond prej rreth 10,000 titujsh me tematika të shumëllojshme, të lidhura kryesisht me programet e studimit që ofron institucioni, ku një pjesë e madhe e tyre janë dhe botime të kohëve të fundit. Në bibliotekë janë të disponueshëm periodikë të ndryshëm si në trajtë të shtypur ashtu dhe elektronikë, për të gjitha fushat të lidhura me programet e ofruara nga Universiteti.

Institucioni ka gjithashtu një hapësirë ekspozitash, e quajtur *MAD Centre* ku zhvillohen ekspozita të studentëve apo dhe artistëve të jashtëm. Në fakt, bie në sy që korridoret e institucionit shërbenin gjithashtu si hapësira ekspozuese duke pritur punët e ndryshme të studentëve.

Në katin e fundit të objektit ndodhet menca e hapur si për stafin ashtu dhe për studentët. Vëreheshin gjithashtu një sërë hapësirash që shërbenin për studentët dhe zhvillimin e aktivitetet jashtë orarit të mësimin. Shërbimet e tjera për studentët si mjediset për fotokopjimet, sekretaritë, salla konsultimesh, nyje sanitare, etj ishin të disponueshme dhe të mjaftueshme.

Stafi gjithashtu kishte hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit të tij si dhe për çdo staf kishte minimalisht një post të dedikuar të pajisur me PC.

Ambjentet e jashtme janë gjithashtu të kuruara dhe të pajisura për zhvillime të aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive.

GVJ gjykon që infrastruktura e ofruar nga Universiteti POLIS është cilësore dhe mëse e përshtatshme si për stafin ashtu dhe studentët për të ofruar në mënyrë cilësore programet e studimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese

- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Siç raportohet dhe në RVB, verifikuar dhe nga GVJ, institucioni garanton një infrastrukturë moderne për sa i përket procesit akademik dhe kërkimor në fushat e interesit, përfshi laboratorët e nevojshëm, me një sipërfaqe totale mbi 6,300 m² mjedise të drejtpërdrejta pa përfshirë këtu infrastrukturën ndihmëse. Më konkretisht institucioni ka një hapësirë për aktivitetin akademik me një mesatare prej 2.4 m²/ student (9 salla leksionesh, 8 klasa për seminare/studio dhe laboratore CAD/MAC, 1 sallë konferencash, laboratore për lëndët, etj.). Hapësirat sekondare si salla interneti, biblioteka, librari, arkiva, zyra informacioni, salla konsultimesh, etj., kanë një standart prej 1.7 m²/student. Pjesa tjetër janë hapësira për aktivitete rekreative dhe shërbime. Në total vihet re që për studentët ka 92 ambjente me një mesatare prej 6.1 m²/student. Infrastruktura në mënyrë më të detajuar mund të gjendet në aneksin e këtij raporti (Tabela 7. Mjediset / infrastruktura e Universitetit / Fakultetit në funksion të programit të studimit).

GVJ gjykon që hapësirat janë konform atyre të deklaruara nga institucioni si dhe janë me standarde shumë të mira për zhvillimin optimal të procesit të mësimin. Ky opinion ndahet dhe nga vetë studentët gjatë takimit me to.

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Për stafin akademik dhe administrativ ka gjithsej 16 ambjente të dedikuara ku shihet se ka, në përgjithësi, një mesatare të balancuar për cdo tipologji zyre duke qënë afër mesatares së përgjithsme prej 5 m²/person. Ambjentet janë të gjitha bashkëkohore dhe të pajisura me instrumenta të teknologjisë së informacionit. GVJ gjen që hapësirat e dedikuara për stafin akademik janë të pështatshme për zhvillimin e aktivitetit të tyre me cilësi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	GVJ gjatë vizitës në institucion i kushtoi vëmendje të veçantë vizitës tek biblioteka dhe me shumë kujdes pa edhe literaturën dhe botimet që janë të lidhura me këtë program studimi. Referuar edhe RVB por edhe të dhënave nga punonjësi i bibliotekës, GVJ ju komunikua se Institucioni ka një bibliotekë me një fond prej rreth 10,000 titujsh me tematika të shumëllojshme të lidhura kryesisht
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;

Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.

me programet e studimit që ofron institucioni, ku një pjesë e madhe e tyre janë dhe botime të kohëve të fundit. Një pjesë e madhe e këtij fondi është siguruar me blerje por një kontribut i rëndësishëm është dhënë nga projektet TEMPUS/Erasmus+, donacionet nga universitete partnere si IHS/Erasmus, IAUV, etj., nga NGO si Co-PLAN apo dhe nga vetë stafi dhe studentët. Biblioteka ndjek një strategji pasurimi të vazhdueshme nëpërmjet blerjeve, donacioneve, projekteve të ndryshme ndërkombëtare apo botimeve të vetë stafit të Universitetit.

Në sylabuset e çdo lënde është e përcaktuar qartë si literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar. Nga verifikimet e bëra dhe me konfirmim të studentëve gjatë takimit me GVJ, literatura e detyrueshme është gjithmonë e pranishme në bibliotekë ndërkohë që dhe pjesa më e madhe e literaturës së rekomanduar është e pranishme në bibliotekë ose lehtësisht e aksesueshme në forma digjitale.

Eshtë evidentuar që në literaturën e detyruar përfshihen dhe tekste mësimore/botime të bëra enkas për lëndën në fjalë apo nga pedagogët e lëndës të cilat janë lehtësisht të gjindshme në bibliotekë. Në veçanti për programin Bachelor në Studime Mjedisore janë botuar nga Universiteti disa libra si “Shkenca e Tokës 1”, “Shkenca e Tokës 2”, “Shkenca e Mjedisit dhe Planifikimit Urban 1”, “Shkenca e Mjedisit dhe Planifikimit Urban 2”, etj., apo përkthime si ai librit “Qytete për njerëzit”, i Jan Gehl.

Ndërkohë për të gjitha rastet, pedagogët vënë në dispozicion të studentëve dispensa të lëndës të cilat janë të disponueshme, si në një seksion të veçantë të bibliotekës, ashtu dhe në kancelarine e universitetit

Në bibliotekë janë të disponueshëm periodikë të ndryshëm si në trajtë të shtypur ashtu dhe elektronikë për të gjitha fushat të lidhura me programet e ofruara nga Universiteti. Ndër to mund të përmenden Modulo, Domus, Detail, Journal of Environmental Planning and Management, Journal of Regional Studies, Waste Management and Research, etj. Vlen për t’u theksuar dhe prania e revista periodike shkencore, botim i vetë Universitetit POLIS, si Forum A+P, MAD Magazine e në mënyrë të veçantë HABITAT Magazine me ISSN ndërkombëtare 2306-8779. HABITAT Magazine, i botuar shpesh në shqip dhe anglisht, përqendrohet në dokumentimin punës në njësisë kërkimore Sust_Lab pranë Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban shpesh duke përfshirë dhe kërkime shkencore (papera apo prezantime konferencash) të bëra dhe nga studentët. Fokusi kryesor është në çështjet mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

Të disponueshme janë gjithashtu dhe libra në trajtë elektronike. Përgjegjësit e departamenteve dhe programeve të studimit, në bashkëpunim me fakultetet, rektoratin dhe financën, hartojnë plane për të shtuar literaturën e bibliotekës çdo vit akademik. Planet e projekteve kërkimore shkencore dhe pasurimi i bibliotekës me tituj të rinj hartohen në mbështetje të programit të

	<p>studimit dhe të përgatitjes së tezës së diplomës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar.</p> <p>Biblioteka funksionon çdo ditë të javës (nga e hëna në të dielë), përveç festave zyrtare, dhe është në shërbim të studentëve nga ora 08:00-17:00 duke qënë në dispozicion të studentëve plotësisht gjatë orareve të zhvillimit të programit të studimit.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në UP se ky Institucion ka një infrastrukturë bashkëkohore, më se të mjaftueshme, për realizimin në kushte të mira të programit të studimeve. Ambjentet e institucionit janë të shumëllojshme dhe me karakteristika specifike në varësi të përdorimit që kanë. Klasat janë të gjitha të pajisura me aparate elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (kompjutera, videoprojektor, etj.) duke lehtësuar mundësinë e një mësimdhënie cilësore.</p> <p>Sic edhe është përmendur edhe në pjesën përshkrimore, Auditorët gjithashtu janë të pajisura me kompjutera dhe sisteme audio e video, çka ndihmon në mënyrë optimale jo vetëm zhvillimin e mësimin por dhe aktivitetet e tjera si seminare, konferenca, etj. Ndërkohë në institucion ka të pranishme hapësira të tjera si zyra, studio, salla mbledhjesh e takimesh, hapësira për studim jashtë mësimin, galeri ekspozimi, etj., të cilat janë të gjitha të pajisura me me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Në të gjitha hapësirat e institucionit është e mundur aksesin në internet nëpërmjet rrjetit wi-fi.</p> <p>Mund të thuhet që kapaciteti infrastrukturor dhe teknologjik i mjediseve mësimore është në përputhje me qëllimet e programit duke plotësuar të gjitha kërkesat specifike të tij.</p> <p>Siç përmendëm dhe më lart, institucioni ka një sërë laboratorësh të pajisura me aparatura dhe mjete të nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit Bachelor në Studime Mjedisore. Në veçanti Laboratori i Mjedisit i cili ka filluar aktivitetin e tij që në 2015, mbështetur nga projekti CONSUS në kuadër të Programit Tempus financuar nga BE.</p> <p>Laboratori ka si funksion mësimdhënien, praktikat laboratorike/mësimore dhe shërben si një aset i shkëlqyer dhe për kërkimin shkencor si për studentët ashtu dhe për stafin. Laboratori është i pajisur me një gamë të gjerë aparatash bashkëkohore duke lejuar kryerjen e një shumëllojshmërie analizash të ajrit, tokës, ujit, etj., rritur kështu cilësinë e mësimdhënies, aftësimin praktik dhe profesional të studentëve si dhe zhvillimin e temave të diplomave apo kërkimeve shkencore në përgjithësi, jo vetëm teorike por edhe eksperimentale.</p> <p>Institucioni ka 2 laboratorët e teknologjisë së informacionit, njëri me SO Windows dhe tjetri me SO MAC, të dyja të pajisur me programe profesionale të domosdoshme për programet e studimit (programe si GIS/CAD/SAP/ETABS/TEKLA, OFFICE, ADOBE, etj.).</p>

Siç është konstatuar gjatë vizitës në institucion, ka një ndjesi tejet pozitive nga studentët që shfrytëzojnë labororet, të cilat përdoren mjaft shpesh nga lëndë të ndryshme. Gjithashtu janë për t'u përmendur dhe raste bashkëpunimesh të pedagogëve dhe studentëve me subjekte të tjera (NGO apo institucione të pushtetit lokal) me qëllim përfitimin e rezultateve për monitorimin dhe "mapimin" e ndotjeve të ndryshme.

Studentët angazhohen shpesh për zhvillimin e praktikave të tyre në institucione partnere të Universitetit si dhe në projekte të aplikuara, si zhvillimi i vlerësimeve mjedisore në planet e përgjithshme vendore, apo në projekte kërkimi.

Nga raportet dhe takimet e bëra, rezultojnë që Universiteti POLIS synon konsolidimin e Laboratorëve të tij dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe private për ofrimin ndaj tyre shërbimesh të specializuara në fushën e mjedisit dhe fusha të ngjashme.

Konkluzione të GVJ:

Për plotësimin e standardeve/kritereve të rubrikës 4, GVJ konkludon sa vijon:

1. Institucioni ka një bibliotekë me një fond prej rreth 10,000 titujsh, me tematika të shumëllojshme, të lidhura kryesisht me programet e studimit që ofron institucioni, ku një pjesë e madhe e tyre janë dhe botime të kohëve të fundit. Nga verifikimet e bëra, del që si literatura e detyrueshme ashtu dhe pjesa më e madhe e literaturës së rekomanduar është e pranishme në bibliotekë ose lehtësisht e aksesueshme në forma digjitale, duke ndihmuar studentin në realizimin me sukses të programit të studimit.
2. Në bibliotekë janë të disponueshëm periodikë të ndryshëm si në trajtë të shtypur ashtu dhe elektronike për të gjitha fushat e lidhura me programet e ofruara nga Universiteti.
3. Përgjegjësit e departamenteve dhe programeve të studimit, në bashkëpunim me fakultetet, rektoratin dhe financën, hartojnë plane për të shtuar literaturën e bibliotekës çdo vit akademik nëpërmjet blerjeve, donacioneve nga partnerë dhe botimeve të stafit të Universitetit.
4. Biblioteka ka orare të sakta dhe është në dispozicion të studentëve plotësisht gjatë kohës së procesit të mësimit dhe akoma më gjatë përgjatë sezoneve.
5. Universiteti POLIS ka një infrastrukturë bashkëkohore dhe mëse të mjaftueshme për realizimin në kushte shumë të mira të programeve të studimit.
6. Institucioni ka një sërë laboratorësh të pajisura me aparatura dhe mjete bashkëkohore që plotësojnë në mënyrë ekselente kërkesat e programeve të studimit, e në vecanti Bachelor në Studime Mjedisore.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

GVJ-së iu vu në dispozicion informacioni financiar ku prezantoheshin burimet e financimit sipas kategorive: fonde publike, donacione dhe grante, tarifat e shkollimit, të ardhura të tjera dhe projekte.

Përvec burimeve u prezantuan dhe përdorimin i tyre ose shpenzimet e kryera nga institucioni gjatë periudhës 2012-2017 sipas kategorisë (paga, shpenzime dhe investime) të lidhura me burimin e financimit të tyre. Ndarja sipas kategorive të veprimtarive është bazuar në angazhimet reale të stafit dhe shpenzimeve në tërësi duke marrë në konsideratë edhe udhëzimin e MAS mbi veprimtaritë e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi:

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Gjatë 5 viteve të fundit Universiteti POLIS është financuar nga burime të shumfishta si: tarifatat e studimit, donacione dhe grante, projekte të përbashkëta dhe të ardhura të tjera.

Vërehet një nivel të ardhurash thuajse konstante nga tarifatat e shkollimit, me vetëm një rritje të vogël, ndërkohë që shikohet një rritje thuajse shtatëfishi i të ardhurave nga donacione dhe grantet. Një rritje substanciale tregojnë dhe të ardhurat e tjera apo projektet që menaxhohen nga partnerët, respektivisht 4 dhe 2 herë më shumë.

Ajo që vërehet pozitivisht është fakti që nëse në 2013 të ardhurat nga tarifatat e studentëve përbënin rreth 90 % të të ardhurave totale, në 2017 kjo përqindje zbrit me thuajse 15 %.

Në të ardhurat nga donacione dhe grante janë pasqyruar pjesa vjetore që i takon periudhës e granteve në kuadër të projekteve Erasmus+ apo të Future Architecture Platform.

Në tarifatat e shkollimit përfshihen pagesat që bëjnë studentët gjatë vitit akademik përkatës për shërbimin arsimor.

Në të ardhura nga projekte që menaxhohen nga partnerët përfshihen pjesëmarrje direkte të studentëve dhe stafit të Universitetit POLIS në kuadër të projekteve të përbashkëta me partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë. Këto të ardhura nuk kanë hyrë në kontabilitetin dhe llogaritë të Universitetit dhe nuk janë administruar dhe taksuar në POLIS por nga partnerët, me të cilët është zhvilluar projekti. Ama këto janë përfshirë në raport për të paraqitur një pamje të plotë të aktivitetit të Universitetit.

Të ardhura të tjera përfshijnë ato nga aktivitete dytësore si angazhime në hartimin e planeve dhe projekteve të zhvillimit të territorit, konsulencia dhe ekspertiza profesionale, zhvillim kurse dhe trajnime, zhvillim eventesh nga vetë institucioni dhe për të tretë etj.

Shihet kështu qartazi që përgjatë viteve është rritur pesha e burimeve të tjera të financimit duke diversifikuar burimet e financimit. Të ardhurat nga këto burime janë në nivelin 23% të totalit, cka ndikon pozitivisht në uljen e ekspozimit ndaj risqeve të financimit të brendshëm.

(Për informacione më të detajuara shiko Aneksin: Tabela 8- Burimet e Financimit 2012-2017)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Në raportin e gjeneruar janë dhënë shpenzimet totale të ndara në tre kategori: paga, shpenzime dhe investime. Në zërin paga janë përfshirë pagat e stafit akademik të punësuar, me kohë të plotë dhe të pjesëshme, pedagogët e ftuar të huaj si dhe pagat e stafit administrativ.

Në zërin shpenzime përfshihen, shpenzime për botime, shpenzimet për konferenca, ëorkshope, ture mësimore, promovim, qera, shpenzimet korente të përfshira në kuadër të projekteve, hartim plane e projekte dhe shpenzime të tjera.

Në zërin investime janë përfshirë shpenzimet për blerje asetesh si krijim, kompletim laboratore, pajisje kompjuterike, shpenzime për blerje librash, mobilje orendi e pajisje klasa, donacione në libra nga partnerë etj. Shpenzimet janë dhënë të ndara sipas burimit të financimit.

Ajo që bie në sy është mbajtja e një ritmi konstant investimesh për pasurimin e aseteve të universitetit. Elementi pozitiv është që përgjatë 5 viteve të fundit duket që ka një ulje të shpenzimeve dhe investimeve të bëra nga tarifat dhe zëvendësimin e tyre nga të ardhura nga grante dhe projekte.

Nga të dhënat e viteve të fundit, kosto totale e studimi për student ka qënë rreth 300 mijë lekë në vit akademik. Ky tregues është i lartë fillimisht në programet e reja që hapen apo në ato programe që kanë numër të ulët të studentëve. Me konsolidimin e programeve këto kosto ulen në nivelin e përballueshmërisë nga tarifa e shkollimit dhe të ardhurat e tjera.

(Për informacione më të detajuara shiko Aneksin: Tabela 9 - Shpenzimet sipas burimeve të financimit)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se monitorimi i gjendjes financiare kryhet në dy dimensione.</p> <p>Së pari institucioni kryen rregullisht një monitorim të brendshëm, i raportuar nga zyra e financës dhe i monitoruar dhe miratuar nga bordi i administrimit. Zyra e financës harton këto raporte për periudha 6 mujore, 1 vjeçare dhe 3 vjeçare afatmesme, të cilat analizojnë buxhetin e flukseve monetare, vlerësojnë kostot për njësi për çdo program studimi, nivelin e regjistrimeve, pozitën e institucionit në treg, pasqyrat financiare vjetore, etj.</p> <p>Së dyti, monitorimi i aktivitetit financiar kryhet edhe nga një kompani ndërkombëtare e liçencuar në fushën e kontabilitetit. Kjo kompani kryen çdo vit auditimin e raporteve të pasqyrave financiare sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit duke hartuar një raport bashkangjitur dokumentave financiare të institucionit.</p> <p>Në raportin e dorëzuar të vlerësimit të brendshëm paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, të ardhurat dhe origjina e tyre, etj.</p> <p>Raporti përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë si dhe alokimin e këtyre të ardhurave në shpenzimet/investimet e bëra.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	

Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Institucioni harton raporte vjetore financiare që përmbajnë të dhëna për aktivitetin financiar të tij.

Këto raporte janë të disponueshme për të gjitha vitet akademike.

Institucioni ndjek një strategji diversifikimi të flukseve hyrëse duke përdorur kapacitetet infrastrukturore, njerëzore, teknike dhe profesionale për të krijuar të ardhura nga burime të tjera. Kjo strategji ka sjellë më shumë të ardhura nga burime të tjera alternative përtej tarifave të shkollimit apo aktivitetit primar akademik, të përkthyer më pas në investime dhe shpenzime në aktivitetin institucional dhe për çdo program studimi. Kjo dëshmon një rritje të efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe kapaciteteve të Universitetit. Të ardhurat dytësore vitet e fundit kanë arritur në mbi 20% të të ardhurave totale duke dëshmuar një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit.

Konkluzionet e vlerësimit të GVJ për plotësimin e standardeve/kritereve në rubriken 5:

1. Grupi i vlerësimit konstatoi se Universiteti POLIS ka një auditim të përvitshëm (të jashtëm) të situatës financiare. Për më tepër hartohet një raport financiar në të cilin parashikohen kostot e programeve të studimit, të ardhurat nga tarifat, nga grantet, shërbimet e konsulentëve, etj., si dhe shpenzimeve. Kjo shërben për një reflektim të drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë akademike.
2. Institucioni ndjek një strategji diversifikimi të flukseve hyrëse duke përdorur kapacitetet infrastrukturore, njerëzore, teknike dhe profesionale për të krijuar të ardhura nga burime të tjera.
3. GVJ konstaton që të ardhurat nga tarifat e shkollimit janë në rritje, cka reflekton tashmë një nivel prurjesh konstante nderkohe edhe të ardhurat dytësore, vitet e fundit, kanë arritur në rreth 23% të ardhurave totale, duke rritur kështu kapacitetin e investimeve dhe duke dëshmuar një qëndrueshmëri financiare të institucionit.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm grupi i vlerësimit shpreh:

Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në përputhje të plotë me këtë ligj, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit POLIS, institucioni ka ngritur një njësi të qëndrueshme, strukturimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i së cilës përcaktohet qartë në “Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë” miratuar me vendim të Senatit Akademik. Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të

veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit POLIS.

Si aneks të RVB, institucioni ka dorëzuar dhe "Rregullore e NJBSC". NJBSC ka këtë emërtim qysh në ristrukturimin e saj të fundit në vitin akademik 2012-2013, por ka qënë aktive me emërtime të tjera por në thelb me aktivitet e qëllim të ngjashëm që nga themelimi i institucionit. NJBSC është një njësi e përhershme e pavarur, e cila nëpërmjet punës së saj në vlerësimin e cilësisë, synon krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në Universitetin POLIS. Njësia përbëhet nga 9 anëtarë (Në Aneks të raportit: Tabela 10. Përbërja e Njesisë së brendshme të Sigurimit të Cilësisë), një ndër të cilët është përfaqësues i Studentëve, një përfaqësues i Alumni dhe një përfaqësues i Komunitetit të Biznesit (tregut të punës). NJBSC është një organ me karakter të përhershëm, vlerësues dhe këshillimor si dhe ka autonomi operative dhe qasje në të gjitha të dhënat e institucionit.

Parimet mbi të cilat është ndërtuar SBC janë:

1. Krijimi i një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të universitetit.
2. Ngritja e një sistemi efikas për sigurimin dhe krijimin e kulturës së cilësisë në institucion.
3. Garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e institucionit, njësive, programeve, shërbimeve, etj.

Gjatë takimit me anëtarët e NJBSC u verifikuan të dhënat e përcjella nga RVB si dhe u konstatua se kishte një ndarje të qartë të detyrave të anëtarëve të njësisë, ku secili ishte i angazhuar me një aspekt specifik duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në verifikimin dhe përmirësimin e cilësisë. Më konkretisht, një nga anëtarët ishte i angazhuar me menaxhimin e procesit të vlerësimit të mësimdhënies, një tjetër me monitorimin e proceseve administrative, një ishte përgjegjës për verifikimin e procesit kërkimor shkencor, etj. Në këtë mënyrë krijohet një tablo e gjerë, gjithëpërfshirëse, e qartë dhe konkrete në fushën e cilësisë dhe përmirësimit të saj.

Metodologjitë dhe instrumentat matëse dhe vlerësuese të verifikuara nga GVJ (formularët, raportet, strategjitë, apo rezultatet e takimeve) konfirmojnë dhe njëherë objektivat e NJBSC të cilat janë:

- monitorimi i vazhdueshëm i institucionit;
- monitorimi i vazhdueshëm i programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit dhe përditësimit të tyre ;
- ndjekja e vazhdueshme e cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij;
- monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së këtij procesi;
- ndjekja e vazhdueshme e zhvillimit të kërkimit shkencor në institucion ;
- ndjekja e ecurisë së bashkëpunimit të institucionit me institucione të tjera akademike, shkencore dhe jo akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të institucionit;

Institucioni përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë. Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të NJBSC. Në përfundim të çdo viti akademik, të dhënat e procesit të vlerësimit grumbullohen dhe përmbledhen në formën e një Raporti Vjetor që i paraqitet në formë zyrtare Rektoratit për t'ju vënë në gatishmëri Senatit Akademik dhe të gjithë aktorëve të tjerë. Në varësi të dhënave të raportit, nxirren rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procesit të cilësisë dhe mësimdhënies dhe sigurohet që ato të zbatohen në çdo njësi të institucionit.

Universiteti POLIS dhe pse i akredituar për të dytën here me Urdhër Nr. 267, datë 20.05.2016 "Për Akreditimin Institucional të Universitetit "POLIS"", i ka fituar për të tretën here akreditimin periodik institucional në vitin 2017, të realizuar nga ASCAL dhe Agjensia Britanike QAA. Në këtë akreditim të fundit,

Universiteti POLIS është vlerësuar maksimalisht në të gjitha kriteret e vlerësimit, me të 5-ta standardet të përmbushura plotësisht dhe duke i dhënë 6 vite akreditim pa asnjë rekomandim për përmirësim. Gjithashtu është konstatuar që të gjitha programet e ofruara nga Universiteti POLIS janë të akredituara.

Krahas këtyre vlerësimeve “kombëtare”, është konstatuar gjithashtu që Universiteti POLIS i është nënshkruar edhe procedurave të vlerësimit të cilësisë dhe të akreditimit sipas standardeve ndërkombëtare si vijon:

1. Akreditim i përvitshëm nga autoritetet përgjegjëse Italiane në kuadër të programit të përbashkët doktoraturë midis Universitetit POLIS dhe Universitetit të Ferrara-s, duke filluar që nga viti akademik 2013-2014 e në vazhdim.
2. Përmbushja e standardeve të cilësisë dhe kërkesave të akreditimit në vendet e origjinës, IPAG Business School, Paris, Francë dhe IHS/ERASMUS University, Rotterdam, Netherlands në bashkëpunim me të cilat Universiteti POLIS ofron tre programe studimi Master Profesional me nga tre profile secili.
3. Akreditim në Dhjetor 2015 nga AESOP për programin e studimeve të integruara (5-vjeçare) Planifikim dhe Menaxhim Urban.

Institucioni dëshmon angazhim të vazhdueshëm në drejtim të sigurimit të cilësisë, i konfirmuar dhe nga fakti i angazhimit në dy vitet e fundit në një projekt Erasmus+, KA2, me titull QAINAL “Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri” (www.qainal.eu) dhe ku figuron si partner dhe vetë MAS.
Nga të dhënat e gjetura mbi këtë projekt, objektivat e tij janë si më poshtë:

- Të krijojë / mbështetë strukturat e sigurimit të cilësisë / zyrat në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri;
- Të sigurojë ngritjen e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë;
- Të sigurojë trajnime për hartimin e programit të studimit në bazë të nevojave të tregut të punës;
- Të hartojë planet e veprimit mbështetës për proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmisimin në mësimdhënie, mësimnxënie dhe administrim;
- Të modernizojë infrastrukturën e Zyrës së Sigurimit të Cilësisë;
- Të zhvillojë udhëzimet për sigurimin e cilësisë;

Të gjitha faktet e sipërpërmenduar janë një deshmi jo vetëm e përpjekjes së vazhdueshme të Universitetit për të siguruar cilësinë por dhe një konfirmim i cilësisë së siguruar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
- Etj

Anketimet bëhen në fund të çdo semestri për çdo modul të ofruar. Në anketime marrin pjesë të gjithë studentët që kanë frekuentuar modulën, duke e bërë sistemin e vlerësimit një proces gjithëpërfshirës dhe të hapur për të gjithë studentët e regjistruar. Rezultatet e përfituara nga monitorimet dhe vlerësimet përmblidhen në raportet përkatëse dhe bëhen publike për stafin, studentët, administratën si dhe më gjerë (rezultatet për vlerësimin e pedagogëve i komunikohen personalisht pedagogëve ndërkohë rezultatet e përgjithshme bëhen publike si produkte statistikore dhe renditëse por, në formë anonime). Aty ku gjykohet se ka nevojë për përmirësim apo evidentohen raste problematike, nxirren rekomandime dhe lihen detyra apo merren masa për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor dhe cilësinë e mësimdhënies

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Vlerësimi i procesit mësimor mbështetet në: vlerësimin nga studentët, nga kolegët, nga eprorët dhe vetëvlerësimi (Formularët për çdo proces vlerësimi janë vënë në dispozicion të GVJ). Gjetjet kryesore të raportit vjetor bëhen publike dhe diskutohen në një mbledhje të hapur të Senatit Akademik me pjesëmarrje të lirë të stafit. Komponentët ndahen si më poshtë:

- (1) Vlerësimi nga studentët, i cili ka një peshë në vlerësimin total prej 50%. Përbajtja e pyetësorëve është standarte dhe konsiston me një interval vlerësimi nga 1 (minimumi i vlerësimit) deri te 5 (maksimumi i vlerësimit). Plotësimi i pyetësorit është konfidencial dhe plotësohet në mënyrë elektronike.
- (2) Vlerësimi nga kolegët, i cili ka një peshë prej 35% në vlerësimin total. Ky proces kryhet nëpërmjet ndjekjes së procesit mësimor nga kolegët.
- (3) Vetë-vlerësimi, i cili ka një peshë prej 15% në vlerësimin total. Vetëvlerësimi i pedagogëve është gjykuar si një komponent që mund të japi informacione mbi njohjen që vetë pedagogët kanë për cilësinë dhe si një mënyrë që mund të nxis vetkritikën me synim përmirësimin e vazhdueshëm individual.
- (4) Vlerësim nga drejtuesit realizohet përmes një procesi analize dhe feedback të kombinuar edhe me analizat semestrale dhe ballafaqimeve e bisedave informale.
Gjithashtu procesi i kërkimit shkencor ka një monitorim dhe vlerësim. Ky vlerësim bëhet në bazë të një sistemi benchmark të zhvilluar nga FKZh në bashkëpunim me NJSBC dhe përmban 36 kritere vlerësimi.

Vlerësim përfundimtar për performancën e përgjithshme të secilit staf akademik bazohet në rezultatet e vlerësimit të studentëve, kolegëve dhe të vetëvlerësimit përfshi edhe punën shkencore
Në takimin me NJSBC GVJ konstatoi që në rastet kur ka pasur mos-reflektim për komentet e marra më shumë se një herë nga ndonjë staf akademik, stafi menaxhues ka marrë masa deri në nderprerje të kontratës së punës.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Monitorim zhvillohet e koordinohet nga NJSBC dhe rezultatet përmbledhen në një raport i cili dorëzohet pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet janë periodike dhe përmbledhen të gjitha në një raport vjetor të NJSBC. Nga diskutimet me NJSBC, rezulton që në linja të përgjithshme rezultatet e arrira janë mjaft të mira dhe ka vetëm raste të ralla që mund të meritojnë një vëzhgim më të kujdesshëm.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	

Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;

Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

Të tërthorta:

- a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;
- b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;
- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intervista;
- e. Etj.

Të drejtpërdrejta:

- a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Vlerësimi me nota/pikë;
- d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;
- e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatat);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Etj.

GVJ ju komunikua se UP ka një metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve. Monitorimi bëhet në disa drejtime dhe mënyra. Nga formularët e përdorura gjate procesit të vlerësimit, ku angazhohen studentë dhe staf, të vëna në dispozicion të GVJ, rezultojnë që me anë të këtyre kriterëve të vlerësimit bëhet një monitorim i procesit të mësimdhënies, sasisë/cilësisë së literaturës së përdorur, formave pedagogjike, etikës së komunikimit, etj. Njëherazi institucioni me anë të një sere metodash të tërthorta dhe të drejtpërdrejta monitoron ecurinë e studentëve, kalueshmërinë, tregun e punës, punësimin e të diplomuarve, etj, duke ndihmuar kështu në një monitorim të gjerë të ecurisë së programeve të studimeve.

Ky monitorim zhvillohet e koordinohet nga NJBSC dhe rezultatet përmbledhen në një raport i cili dorëzohet pranë dekanateve të fakulteteve dhe rektoratit si bazë për të vlerësuar e marr masa për ecurinë sa më të mirë të programeve të studimeve. E rëndësishme për t'u theksuar është dhe fakti që Universiteti POLIS është një nga përfituesit e Projektit Erasmus+ me titullin QAinAL me qëllim pikërisht ritjen dhe garantimin e sigurimit të cilësisë në institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri ku një nga partnerët është vetë MAS.

Metodologjia e vlerësimit, instrumentet matëse dhe rezultatet mbi ecurinë e programeve të studimit janë të përfshirë në raportet e vetëvlerësimit. Rezultatet bëhen gjithashtu pjesë e raporteve pjesore dhe atyre vjetore të NJBSC si dhe të Raportit Vjetor të institucionit i cili përgatitet çdo fund viti akademik.

Rezultatet e përfituara nga monitorimet dhe vlerësimet e bëra bëhen publike për stafin, studentët, administratën si dhe më gjerë (sic është raportuar gjatë takimit me NJBSC, rezultatet për vlerësimin e pedagogëve i komunikohen personalisht pedagogëve nderkohe rezultatet e përgjithshme pëhen publike si produkte statistikore dhe renditëse por në formë anonime). Nga këto vlerësime, aty ku gjykohet se ka nevojë për përmirësime apo evidentohen raste problematike, nxirren rekomandime dhe lihen detyra apo merren masa për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor dhe cilësinë e mësimdhënies.

Analizat dhe rezultatet, si pjesë të raporteve pjesore apo vjetore të NJBSC si dhe të Raportit Vjetor të institucionit janë publike dhe të konsultueshme lehtësisht ose online ose në arkivat apo bibliotekën e Universitetit POLIS. Sic është komunikuar dhe gjatë vizitës në institucion, këto raporte u dërgohen dhe MASR dhe ASCAL.

Nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuar (raporte, formularë vlerësimesh, strategji, etj.) dhe takimet me njësitë drejtuese, stafin, studentët, NJBSC, ZMSKK, etj., mund të thuhet që institucioni përdor një shumëllojshmeri metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Këtu përfshihen analiza statistikore, sondazhe me gojë e me shkrim, intervista, përpilim formularësh, monitorime në ambientet e mësimdhënies, vlerësime me nota, vlerësime me pike

	<p>(p.sh. kerkimi shkencor), testime, seminare, ëorkshope, takime informale, vëzhgime dhe vlerësime të praktikave, ndjekjen e ecurisë së studentëve, vëzhgime të punësimi pas diplomimit, etj. Subjekt i këtyre metodologjive janë të gjithë aktorët e përfshirë.</p> <p>Analizat dhe rezultatet, si pjesë të raporteve pjesore apo vjetore të NJBSC si dhe të Raportit Vjetor të institucionit janë publike dhe të konsultueshme lehtësisht ose online ose në arkivat apo bibliotekën e Universitetit POLIS. Sic është komunikuar dhe gjatë vizitës në institucion, këto raporte u dërgohen dhe MASR dhe ASCAL.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuar (raporte, formularë vlerësimesh, strategji, etj.) dhe takimet me njësitë drejtuese, stafin, studentët, NJBSC, ZMSKK, etj., mund të thuhet që institucioni përdor një shumëllojshmeri metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Këtu përfshihen analiza statistikore, sondazhe me gojë e me shkrim, intervista, përpilim formularësh, monitorime në ambientet e mësimdhënies, vlerësime me nota, vlerësime me pike (p.sh. kerkimi shkencor), testime, seminare, ëorkshope, takime informale, vëzhgime dhe vlerësime të praktikave, ndjekjen e ecurisë së studentëve, vëzhgime të punësimi pas diplomimit, etj. Subjekt i këtyre metodologjive janë të gjithë aktorët e përfshirë si stafi drejtues, stafi akademik, stafi administrative, studentët, alumni dhe partnerë të ndryshëm, duke përfutur kështu një spektër të gjerë informacionesh, të dhënash dhe rezultatesh që synojnë monitorimin, mbarëvajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit në sintoni me misionin dhe objektivat e vetë programeve dhe e institucionit.</p>
--	---

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen</p>	<p>GVJ thekson se: Universiteti POLIS ka plotësuar të gjitha standardet institucionale.</p> <p>Vlerësimi i këtyre standarteve dhe akreditimi institucional pasues është bërë 3 herë që nga themelimi i institucionit. I fundit ka qënë vlerësimi i jashtëm i cilësisë së institucionit në 2016, i bërë nga Agjensia Britanike QAA së bashku me ASCAL ku dhe i është rikofirmuar akreditimi institucional ma anë të Urdhërit Nr. 267, datë 20.05.2016 “Për Akreditimin Institucional të Universitetit “POLIS””.</p> <p>NJBSC- Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e Universitetit POLIS prej vitesh garanton dhe drejton të gjithë procesin e vetvlerësimit, raportimin dhe ndjekjes e plotësimit të rekomandimeve të mundshme.</p> <p>Si dokumentat e dorëzuara e të shqyrtuara dhe takimet me drejtues, staf dhe studentë gjatë vizitës në Universitetin POLIS dëshmojnë dhe konfirmojnë që institucioni ka një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë, me metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse dhe vlerësues mëse të mjaftueshëm e të qartë për t’a garantuar atë.</p>
---	---

për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Të gjitha politikat e sigurimit të cilësisë në procese akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, Rektorat etj. Procedurat e vlerësimit janë të mirëpërcaktuara dhe periodike (fund të cdo semestri) duke garantuar një monitorim të vazhdueshëm dhe efikas të cilësisë së programeve të ofruara nga institucioni.

Në përdorimin e mekanizmave formalë për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara luajnë rol mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialist të fushës brenda ose jashtë institucionit.

Ndërgjegjësimi i personelit të U_POLIS mbi sigurimin e cilësisë për programet e ofruara në universitet lidhet drejtpërdrejt me vizionin që ka institucioni për të ofruar programe të një cilësie sa më të mirë. Ky proces starton me procedurat e punësimit të një anëtari të ri në stafin akademik, njohjen e tij me vlerat, misionin dhe vizionin e institucionit si dhe duke i kërkuar atij të bëhet pjesë e filozofisë së U_POLIS për të rritur cilësinë dhe për ta siguruar atë si vlerë sociale e kulturore

NJBSC ka një rregullore të mirëpërcaktuar dhe një strategji e plan veprimi konkrete (të dyja të dorëzuara dhe të verifikuara nga GVJ) me synimin e rritjes së vazhdueshmë të standarteve në përputhje me statutin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Konkluzionet e vlerësimit të GVJ për plotësimin e standardeve/kritereve të rubrikës 6:

1. Universiteti POLIS ka metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve.
2. Metodologjia e vlerësimit, instrumentet matëse dhe rezultatet mbi ecurinë e programeve të studimit janë të përfshirë në raportet e vetëvlerësimit. Rezultatet bëhen gjithashtu pjesë e raporteve pjesore dhe atyre vjetore të NJBSC si dhe të Raportit Vjetor të institucionit, i cili përgatitet çdo fund viti akademik.
3. Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior dhe cilësor për vlerësimin e brendshëm.
4. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor një shumëllojshmeri metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.
5. Universiteti POLIS ka plotësuar të gjitha standardet institucionale. Vlerësimi i këtyre standarteve dhe akreditimi institucional pasues është bërë 3 herë që nga themelimi i institucionit. GVJ mësoi që i fundit ka qënë vlerësimi i jashtëm i cilësisë së institucionit në 2016, i bërë nga Agjensia Britanike QAA së bashku me ASCAL ku dhe i është rikofirmuar akreditimi institucional me anë të Urdhërit Nr. 267, datë 20.05.2016 "Për Akreditimin Institucional të Universitetit "POLIS"".
6. NJBSC- Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e Universitetit POLIS, prej vitesh garanton dhe drejton të gjithë procesin e vetvlerësimit, raportimit dhe ndjekjes së plotësimin të rekomandimeve të mundshme.
7. NJBSC ka një rregullore dhe status institucional të mirëpërcaktuar si njësi permanente e mbështetur në anëtarë të brendshëm por dhe me përfaqësues nga studentët dhe nga ALUMNI, duke krijuar kështu një diversifikim dhe efikasitet në mënyrën se si operon në përmirësimin e cilësisë.

8. Procedurat e vlerësimit janë të mirëpërcaktuara dhe periodike duke garantuar një monitorim të vazhdueshëm dhe efikas të cilësisë së programeve të ofruara nga institucioni.
9. Institucioni ka strategji e plane veprimi konkrete me synimin e rritjes së vazhdueshmë të standardeve në përputhje me statutin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi Bachelor në Studime Mjedisore ofrohet nga Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, duke qenë kështu në përputhje të plotë me misionin e ekspozuar në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit. Ky program, siç përcaktohet në Rregulloren Mësimore të tij, ka si objektivi formues atë të dhënies së njohurive formuese të përgjithshme bazë mbi çështje mjedisore si në nivel global dhe lokal. Duke qenë një program i ciklit të parë të studimeve, ka si synim t'u japë studentëve një formim me spektër të gjerë mjedisor. Ky objektivi është në përputhje dhe me shpërndarjen e krediteve/ lëndëve ku afër 18% e krediteve japin një formim të përgjithshëm bazë dhe rreth 50% e krediteve lidhen me disiplina karakterizuese që lidhen me fushën e mjedisit. Kështu, thellimi i formimit në ciklin e parë mund të vijohet më tej në fusha specifike të mjedisit apo të ngjashme me to gjatë angazhimeve profesionale, qoftë brenda apo jashtë vendit, ose gjatë ciklit të dytë të studimeve. Vetë Universiteti POLIS e ofron këtë mundësi të thellimit të studimeve në Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban apo dhe në programe Master Profesional në Peizazh, Planifikim Hapësinor, Strehim dhe çështjet e tokës, etj. Përsa më sipër mund të thuhet që programi zhvillohet në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit (Neni 2 dhe 3 të Statutit të Universitetit POLIS).

Një nga arsyet e nritjes së këtij programi studimesh ka qenë fakti, që në kontekstin shqiptar mungonin specialistët me një përjasje të trajtimit integral të çështjeve mjedisore. Nga DVV, dhe nga vetë gjykimi i GVJ, evidentohet që realitetit shqiptar i nevojiten ekspertë me një qasje të re në zgjidhjen e problematikave mjedisore që prekin vendin tonë. Këto kanë të bëjnë me hartime politikash dhe strategjish mjedisore në makro por dhe për çështje specifike si menaxhimi i integruar i mbetjeve, mbrojtja e biodiversitetit, mbrojtja e pyjeve, ulja e ndotjes mjedisore, nxitja e kulturës së riciklimit, menaxhimi i tokës, menaxhimi i ujrave, impaktet e rreziqeve natyrore, siguria ushqimore, hartimi i VNM e VSM të sakta, ndërgjegjësim i shoqërisë për çështjet mjedisore, etj. Vetë Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, njeh si një nga shtyllat dhe prioritetet kombëtare "Rritjen përmes Përdorimit të Qëndrueshëm të Burimeve & Zhvillimit Territorial (Menaxhimi i Integruar i Ujit, Energjia dhe Toka)".

Për t'ia arritur këtij qëllimi ka nevojë që gjitha çështjet e paadresuara që u përmenden më sipër të trajtohen nga specialistë të fushës të cilët rezultojnë se akoma mungojnë.

Si në dokumentat e lidhura me programin ashtu dhe në kuadër të vizitës së GVJ në institucion, është theksuar dhe vlerësuar që programi Bachelor në Studime Mjedisore është konceptuar si një alternative ndryshe nga çfare ofronte "tregu" i edukimit deri në atë moment.

Nevoja për specialistë të tillë evidentohet dhe nga studimet e tregut të bëra enkas nga institucioni dhe për Bachelor në Studimet Mjedisore (GVJ i është dhënë dhe materiali "Studim mbi tregun në fushën e Mjedisit"), duke konfirmuar gjithashtu dhe hartimin dhe konsolidimin e këtij programi në përputhje me nevojat e tregut e në respekt të rregullores së programit dhe statutit të Universitetit.

Gjykojmë që formimi i marrë nga ky program, aftëson studentët për punësim në nivele të ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore, në sipërmarrje apo studio private konsulence dhe projektimi apo në NGO në fushën e mjedisit apo lidhur me të. Një element kyç në formimin e tyre vlerësohet se është dhe përdorimi Laboratoreve tejet bashkëkohore e e të pajisura ma një gamë të gjerë aparatesh duke i pajisur studentët me kompetenca të specializuara që balancojnë njohuritë teorike me ato praktike.

Përsa më sipër, gjykojmë që programi është në përputhje me qëllimet dhe objektivat e vëna në themelimin e tij, me nevojat reale të tregut Shqiptar e Ndërkombëtar si dhe me vetë Statutin dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit POLIS.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i Studimit Bachelor në “Studime Mjedisore” është licensuar nga Këshilli i Ministrave me VKM, Nr. 406, datë 26.05.2010, “Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private Universiteti POLIS, Tiranë” dhe më programi ka marrë lejen e ushtrimit të aktivitetit akademik me Urdher të MASH nr. 557, datë 09.12.2010 “Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit shkollës së lartë Private POLIS”. Akreditimi i parë i programit është përfituar me Urdhër të MASH Nr. 250, datë 14.06.2013 dhe Njësia Bazë (Kryesore) është Departamenti i Mjedisit pranë Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, miratuar me Vendim Senati, Nr. 1 date 12.09.2016.

Nga raportet dhe takimet me njësitë drejtuese evidentohet fakti që programi i studimit Bachelor në Studime Mjedisore synon të ofrojë një formim të gjerë por dhe me kompetenca të specializuara nëpërmjet kombinimit të njohurive teorike dhe praktike në fushën mjedisit, si dhe ofrimit studentëve të bazave për kryerjen e kërkimit shkencor. Gjykojmë që lëndët dhe modulet e programit mbulojnë mjaft mirë fushat e studimeve mjedisore duke ju mundësuar dhe hapur rrugë studentëve për profilizimin në specializimet mjedisore, si në nivel akademik dhe profesional.

Edukimi mjedisor në këtë program studimi synohet t’i ofrohet studentëve nëpërmjet një qasje ndërdisiplinore, ku përfshihen aspekte teknike dhe socio-kulturore të mjedisit me qëllim ndërtimin e një ure lidhëse ndërmjet shoqërisë dhe mjedisit. Në vija të përgjithshme disa nga objektivat e evidentuara mund të listohen si më poshtë:

- Të aftësojë studentët me kapacitet në menaxhimin e një zhvillimi të qendrueshëm social-ekonomik dhe mjedisor të vëndit;
- Të njohë studentët me çështje të etikës profesionale dhe impaktit shoqëror të kësaj disipline;
- Të pasurojë spektrin në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor mjedisor duke stimuluar aftësitë praktike dhe kompetencat profesionale me një qasje shumëdisiplinore në fushën e mjedisit;
- Të aftësojë studentët me njohuritë bazë të komunikimit, si një instrument të nevojshëm për një karriere të suksesshme profesionale por dhe efikasitet në diseminimin e edukimit mjedisor;
- Të sigurojë një bazë shkencore për studime dhe kërkime të mëtejshme;

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Me vendim të Këshillit të Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, Vendim të Senatit Akademik dhe miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, programi Bachelor në Studime Mjedisore, është një program studimi me kohë të plotë dhe me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike me një total prej 180 ECTS. Çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra, ndërkohe sasia e javeve per çdo vit akademik apo semestër është si më poshtë:

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë u gjet si në DVV.

Programi i studimit Bachelor në Studime Mjedisore përmban 22 lëndë të organizuara në 33 module (37 module të ofruara siç shihet dhe në planin mësimor nëse konsiderojme dhe mundësitë e ndryshme të lëndëve me përzgjedhje) me një kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh akademike. Ky program studimi me kohë të plotë, ofrohet nga Departamenti i Mjedisit, Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban (FPMMU) të Universitetit POLIS. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Bachelor në Studime Mjedisore nëse plotësojnë 180 kredite sipas sistemit ECTS (Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve) ku një krediti të formimit i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit, të ndara sipas rastit në orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij. Ky organizim është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi për arsimin e lartë.

Për hartimin e planeve dhe programeve mësimore është marr parasysh raporti midis formave të ndryshme të veprimtarive formuese. Kështu rreth 18% e tyre (33 ECTS) janë në veprimtari të formimit të përgjithshëm ndërkohë që 50% të tyre (90 ECTS) janë në disiplina të formimit karakterizues që lidhen me fushën. Pjesa e mbetur është ndarë 12% (21 ECTS) në veprimtari formuese integruese, 7% (12 ECTS) në lëndë me zgjedhjen e studentit, 10% (18 ECTS) të lidhura me veprimtari formuese plotësuese si aftësi informatike apo praktika dhe 3% (6 ECTS) të dedikuara për përgatitja e tezës së diplomës.

GVJ gjykon që kurrikula është organizuar në përputhje me objektivat e programit dhe formimin që synon t'i japë studentit duke ruajtur njëherazi një raport të ekuilibruar të tipeve të veprimtarive brenda planit mësimor të programit të studimit.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 8-12 orë në auditor dhe 13-17 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 6-18 orë në auditor dhe 17-19 orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratoret 12-18 orë në auditor dhe 7-13 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 20-05 orë në auditor dhe 0-5 orë punë e pavarur e studentit

GVJ e gjykon këtë ndarje si të përshtatshme nivelin dhe natyrën e programit të studimit si dhe në përputhje me udhëzimet për këtë qëllim.

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Nga rregulloret, takimet me drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit përgjegjes, stafin, ZMSKK-Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimi i Karrierës, NJBSC Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe vëzhgimi i ecurisë të programeve apo përmbajtjes së syllabuse, është evidentuar dhe përpjekja e vazhdueshme për konsolidim të mëtejshëm të programit të studimit, kërkimit, metodave të mësimdhënies apo dhe aktiviteteve dhe projekteve zhvillimore të lidhur me të. Konsolidimi i mëtejshëm i programit të studimit nënkupton dhe rishikimin e planit mesimor në mënyrë që të forcohet sa më shumë lidhja e tij me misionin dhe strategjinë institucionale si dhe të qendrojë në sintoni me kërkesat potenciale të një shoqërie e tregu në evoluim të vazhdueshëm. Nga shqyrtimi i materialeve të vëna në dispozicion rezultoi se në programin e studimit Bachelor në Studime Mjedisore ka patur disa ndryshime në planet mesimore nga 2012 deri me 2018 duke pasur ndryshime që në thelb nuk tejkalojnë 15% të programit (27 ECTS). Ndryshimet në lëndë janë si me poshte:

Lënda 1: Edukim dhe Politika Mjedisore (6 ECTS) u ndryshua me Edukim Mjedisor (3 ECTS)

Lënda 2: Filozofi Hapsire (3 ECTS) u ndryshua me GIS 2 (6 ECTS)

Lënda 3: Ekologji (6 ECTS) u ndryshua me Gjeometri dhe Dokumentim Grafik (6 ECTS)

Lënda 4: Gjeografi Urbane (6 ECTS) u ndryshua me Kimi (6 ECTS)

Lënda 5: Sherbime Publike (6 ECTS) u ndryshua me Demografi (6 ECTS)

GVJ gjykon që këto ndryshime janë në funksion të përmirësimit të programit duke e pasuruar me lëndë më teknike që gjejnë një aplikim më konkret falë pasurimit të laboratorëve të CAD/GIS dhe Laboratorit të Mjedisit (rekomandim i lënë ndër të tjerat nga akreditimi i fundit) dhe aftësisit të studentëve për t'u përgjigjur më mirë nevojave të tregut të punës duke e përforcuar akoma më shumë sintoninë e programit të studimit me misionin dhe strategjinë e institucionit.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (*Në Aneks: Tabela 13. Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës*)

Nga shqyrtimi i planeve mësimore rezulton se stafi i angazhuar në programin Bachelor në Studime Mjedisore përbëhet nga 19 pedagogë Personel Akademik Efektiv (me kohë të plotë) dhe 8 pedagogë Personel Akademik me Kontratë (staf me kohë të pjesëshme), duke u ndarë kështu në 70.4 % Personel Akademik Efektiv dhe 29.6 % Personel Akademik me Kontratë. Nga stafi i angazhuar në programin e studimit, 4 janë me titull Prof. Dr., 1 me titull Prof. Ass. Dr., 1 me gradën shkencore Docent-Doktor, 8 me gradën shkencore Doktor, 8 në proces doktorature dhe 5 me gradë shkencore MSc. Nga 37 module që zhvillohen pa internshipin (modulet totale janë 33 siç është parashikuar në rregullore por duke qënë se në Lëndët me Përzgjedhje ka më shumë se një mundësi në total, modulet e "ofruara" në këtë vit akademik, përfshirë dhe module me kredite formative kstr-kurrikulare, janë 37), 28 mbulohen nga personel akademik efektiv, 5 në bashkëpunim PAE dhe PAK dhe 4 mbulohen nga personel akademik me kontratë. I gjithë personeli i angazhuar në mësimdhënie ka së paku kualifikimin e ciklit pasadhës. Drejtuesit e moduleve, në përgjithësi, kanë titullin Profesor. ose gradën Shkencore Doktor, si dhe kualifikim Master Shkencor / MND të cilët këta të fundit janë të gjithë në Proces Doktorature. Rreth 2/3 e stafit efektiv të këtij programi ka tituj e grada, ndërsa gjithë të tjerët janë në proces kualifikimi, ndërkohë ajo që bie në sy është që mbi 75% e Personelit Akademik Efektiv të angazhuar në këtë program studimi janë staf i njësisë kryesore përgjegjëse për programin (FPMMU. Nëse shihet në nivel modulesh rreth 85 % të tyre kanë të angazhuar staf të FPMMU duke mbuluar kështu në mënyrë të shkëlqyer drejtimit më specifike e të profilizuara. Po të merret parasysh që dhe raporti staf efektiv/student është diku në raport 1/2, kjo e bën akoma dhe më te realizueshem një proces mësimdhënie të cilësisë së lartë. Ndërkohë që angazhimi i stafit nga njësitë e tjera mbulon drejtime të përafërta, shpesh në kuadrin e programeve të tjera të studimit të institucionit në të dy nivelet Bachelor dhe Master, me qëllim garantimin e një balance mes specializimit, ndërdisiplinaritetit dhe kërkimit që përbën filozofinë e institucionit.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset e dorëzuara si pjesë e DVV (të gjitha syllabuset e programit Bachelor në Studime Mjedisore) janë të gjitha të unifikuar në një standart/ format, dhe në brendi të tyre përmbajnë të gjithë elementët e mëposhtëm.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik

- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Nga takimet në institucion rezultojnë që, me miratimin e Fakultetit dhe pa cënuar lirinë akademike të stafit, syllabuset janë subjekt kontrolli të përvitshëm nga ana e departamentit përgjegjës për programin. Qëllimi është ai i garantimit që syllabusi të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme si dhe të reflektojë përmbajtjen e saktë e të duhur të lëndës për garantimin e një procesi mësimdhënie cilësor.

Syllabuset kanë të qarta objektivat e lëndës, të cilët janë në përputhje me objektivat e përgjithshëm të programit të studimit. Përmbajtja e tyre dhe metodologjitë e përdorura garantojnë një mësimdhënie cilësore që balancon dhe aspektet teorike dhe ato praktike. Modulet trajtojnë tema relevante për formimin e studentëve dhe bazohen në literaturë mjaft bashkëkohore e cila është e aksesueshme në bibliotekën e universitetit në trajtën e librave apo dispensave. Nga takimi me stafin, është konfirmuar se syllabuset hartohen nga titullarët e lëndëve dhe më pas miratohen në departamentin e fakultetit përgjegjës. Është evidentuar gjithashtu integrimi i metodologjive të larmishme të mësimdhënies dhe i përdorimit të aseteve laboratorike, zbatimi i të cilave është konfirmuar dhe gjatë takimit me studentët. Studentët gjithashtu janë shprehur se syllabuset janë të qarta dhe njihen me to që në fillim të lëndës, pasi janë dhe të aksesueshme online në portalin e studentit, si dhe konfirmuan respektimin e tyre gjatë semestrit si dhe lehtësimin që sjell ky fakt në menaxhimin e kohës në mënyrën e duhur për të plotësuar të gjitha detyrat/ projektet dhe detyrime të tjera.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

I gjithë materiali i vënë në dispozicion me anë të DVV është i verifikueshëm dhe i aksesueshëm nga ana e GVJ në institucion. Materiali i dorëzuar është konform fakteve të verifikuar në institucion.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Të gjitha programet e ofruara nga Universiteti POLIS rezultojnë të akredituara. Programi i Studimit Bachelor në Studime Mjedisore është licensuar nga Këshilli i Ministrave me VKM, Nr. 406, datë 26.05.2010, dhe me leje ushtrimi të aktivitetit akademik me Urdher të MASH nr. 557, datë 09.12.2010. Programi është i akredituar me Urdhër të MASH Nr. 250, datë 14.06.2013</p> <p>Të gjitha programet janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Studime Mjedisore përmban 22 lëndë të organizuara në 33 module (37 module të ofruara nëse konsiderojme dhe mundësitë e ndryshme të lëndëve me përzgjedhje) dhe ka një kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh akademike. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Bachelor në Studime Mjedisore nëse plotësojnë 180 kredite sipas sistemit ECTS.</p>

	<p>Programi Bachelor në Studime Mjedisore, është një program studimi me kohë të plotë dhe me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike me një total prej 180 ECTS. Çdo vit akademik, i ndarë në dy semestra, ka 60 kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</p> <p>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Njësitë kryesore, hartojnë në fillim të çdo viti akademik planin mësimor të programit të studimit dhe japin të gjitha informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve. Çdo program studimi ka një rregullore të qartë dhe publike ku ekspozohen objektivat formuese, profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit, njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin, mundësitë për punësim, niveli i studimit/cikli i studimit, kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit (në vite), forma e studimeve, veprimtaritë formuese, kreditet, kërkesat për pranimin, informacioni për konkurimin në program, kriteret e pranimit, procesi i përzgjedhjes dhe testi i pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit të programit, etj., si dhe një plan të qartë e të mirëpërcaktuar mësimor.</p> <p>Programi Bachelor në Studime Mjedisore ofrohet nga Fakultetiti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, duke qenë kështu në përputhje të plotë me misionin e ekspozuar në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit. Ky program, siç përcaktohet në Rregulloren Mesimore të tij, ka si objektivi formues atë të dhënies së njohurive formuese të përgjithshme bazë mbi çështje mjedisore si në nivel global dhe lokal. Duke qenë një program i ciklit të parë të studimeve, ka si synim t'u japë studentëve nje formim me spektër të gjerë mjedisor.</p> <p>Njësitë kryesore, në planin mësimor që zhvillojnë përfshijnë informacionet të plota mbi lëndët dhe modulet e programit ku përcaktohen qartë ndarjet sipas tipeve të veprimtarive, kreditet përkatëse sipas ECTS, tipologjinë e tyre nëse janë të detyruara apo me përzgjedhje, mundësitë e lëndëve me përzgjedhje, pedagogët përkatës, etj.</p> <p>Nga shqyrtimi i materialeve të programeve të studimit dhe planeve të tyre mësimore, mund të konfirmojmë që informacioni i dhënë nga njësitë kryesore është mëse i plotë dhe ka të qartë ngarkesën mësimore, orët në auditore, praktikat mësimore, frekuentimin/ ndjekjen e programmi, format e mësimdhënies, shpërndarja e peshës së tyre, etj.</p> <p>Të gjitha këto informacione janë verifikuar gjatë vizitës në institucion. Duhet thënë gjithashtu qe një pjesë e madhe e tyre përfshihet dhe në syllabuset e secilës lëndë ku mund të gjenden dhe objektivat e lëndëve, materialet mësimore të nevojshme, detyrat, sistemi i vlerësimit etj.</p> <p>Nga vizita ne institucion është konstatuar që materialet në lidhje me të gjitha informacionet e programeve janë lehtësisht të aksesueshme, në varësi të tipologjisë së tyre, pranë Sekretarisë Mësimore, Bibliotekës apo Zyrës së Shërbimeve si dhe një pjesë</p>

e mirë e tij mund të gjendet dhe online në faqen eeb te Universiteti POLIS.

Gjithashtu është evidentuar që në kontratat që lidhen me studentët ka një aneks ku studentit i bëhet e ditur statusi i programit, i jepen rregulloret dhe guidat e studentit (pjesë e DVV). Ndërkohë ditën e parë të shkollës i bëhet një guidë në institucion dhe i transmetohet një info e plotë.

Në çdo lëndë gjithashtu, pedagogët përkatës në fillim të saj bëjnë një prezantim shterues me të gjitha informacionet mbi syllabusin dhe përmbajtjen e lëndës, material i aksesueshëm nga studentët dhe në portalin e tij.

Për t'u përgëzuar është dhe ngritja e funksionimi i Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës që garanton një transmetim informacioni, këshillim gjatë studimeve si dhe fasilitim të praktikave mësimore.

Konkluzionet e vlerësimit të GVJ për plotësimin e standardeve/kritereve në rubrikën 7:

1. Universiteti POLIS ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Aktualisht të gjitha programet e ofruara nga institucioni janë të akredituara dhe të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)
2. Programi Bachelor në Studime Mjedisore, i akredituar me Urdhër të MASH Nr. 250, datë 14.06.2013, është në përputhje me Statutin, Rregulloren dhe Strategjinë e Zhvillimit të institucionit, duke plotësuar më së miri misionin dhe objektivat e institucionit. Program është me kohë të plotë dhe me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike me një total prej 180 ECTS. Çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra, ka 60 kredite ECTS.
3. Nga shqyrtimi i programit rezulton se ka një staf te kualifikuar, një plan mësimor me raporte e balanca shumë të mira te raporteve staf/student (1/2), raportit PAE/PAK (70/30 %), shpërndarjes së tipeve të veprimtarive dhe të ngarkesave e peshave mësimore.
4. Nga vizita e kryer ne institucion dhe shqyrtimi i materialeve të vëna në dispozicion, rezulton se njësitë kryesore, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, hartojnë në fillim të çdo viti akademik planin mësimor të programit të studimit dhe verifikojnë përputhshmërinë ligjore e programore dhe plotërinë e dokumentave të lidhur me të.
5. Rregulloret e programeve të studimeve japin një pasqyrë të qartë të objektivave formuese, profilin profesional, njohuritë dhe kompetencat e profilit, mundesitë e punesimit, ciklin e studimit, kohëzgjatjen, kreditet, kriteret e pranimit, etj.
6. Planet mësimore përfshijnë të gjitha informacionet e nevojshme mbi sasinë e lëndëve/moduleve, tipeve të veprimtarive, kreditet përkatëse sipas ECTS, stafin, ngarkesën mësimore, orët në auditore, praktikat mësimore, frekuentimin/ ndjekjen e programmi, format e mësimdhënies, shpërndarja e peshës së tyre, etj. Akoma më shterues bëhet informacioni në syllabuset e secilës prej lëndëve, të verifikuara dhe këto nga GVJ, ku përcaktohen më në detaje objektivat e moduleve, frekuentimin/ ndjekjen e programmi, materialet mësimore/literatua,metdologjitë e mësimdhënies, oraret, detyrat, provimet, sistemi i vlerësimit etj.
7. Evidencat tregojnë se materiali dhe informacioni në lidhje me programet është i plotë si dhe ka informacionin një mekanizëm transparent të shpërndarjes së informacionit nëpërmjet kanaleve të shumfasishta, duke nisur nga faqja e institucionit në eeb e duke vijuar me Departamentet, Sekretarinë Mësimore, Bibliotekën apo Zyrën e Shërbimeve sipas materialit specifik.
8. Çdo studenti, që në fillim të vitit të parë i vihet në dispozicion Guida e Universitetit si dhe i bëhet një prezantim i plotë i institucionit. E njëjta procedurë ndiqet dhe për cdo lëndë/modul të planit mësimor, ku çdo pedagog në fillim të lëndës/modulit u prezanton studentëve përmbajtjen e plotë

të saj si dhe materialet plotësuese. Ai iua bën të qartë se të gjitha materialet janë të asesueshëm onlinë në portalin e gjithsecilit.

9. GVJ vlerëson që informimi dhe këshillimi i studentëve edhe për këtë PS nuk konsiston vetëm në hapat e para por gjatë gjithë kohës së studimeve dhe më tej edhe gjatë karrierës së tyre akademike, falë burimeve informative dhe strukturave përgjegjëse të institucionit e, në mënyrë të veçantë, punës dhe përvojës së Zyrës për Mbështetjen e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe shoqates Alumni.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësive etj.

Nga dokumentat e dorëzuara dhe nga evidencat e nxjerra gjatë takimit me njësitë drejtuese, stafin akademik dhe NJSBC-në, u konstatua që organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies është një proces i cili monitorohet dhe vlerësohet vazhdimisht duke marrë parasysh opinionet e të gjithë të interesuarve nga dhe për këtë proces. Nw syllabuset e lëndëve është konstatuar që ka një seksion të dedikuar mbi metodologjinë dhe anën didaktike. Nga takimi me stafin u konfirmua fakti që stafi akademik ka lirinë e tij akademike në përzgjedhjen e metodave më të përshtatshme për të zhvilluar dhe organizuar lëndën përkatëse, por, që stimulohet dhe trajnohet për integrimin e metodave inovative të mësimdhënies. Ky fakt vërtetohet dhe nga pjesëmarrja e institucionit si partner në projektin Tempus ConSus (www.consus-tempus.com) ku një nga objektivat e projektit ishte nxitja e institucioneve partnere të aplikojnë 4-6 metoda inovative për mësimdhënien. Në kuadër të këtij projekti, një pjesë e stafit u trajnuan pranë institucioneve partnere mbi metodat inovative të mësimdhënies duke shpërndarë më tej këtë eksperiencë me pjesën tjetër të personelit akademik të institucionit nëpërmjet trajnimeve dhe workshopeve që u zhvilluan në Universitetin POLIS. Kjo eksperiencë ka ndikuar pozitivisht në përhapjen më të gjerë të këtyre metodave të mësimdhënies si të mësuarit e bazuar tek problemi (PBL), World Café, Modeli Canvas, lojrat edukative, etj.

Siç dhe përmendet në raportin e vlerësimit të brendshëm, krahas formave standarde të mësimdhënies "njëdrejtimore" (nga pedagogu tek studenti), në institucion janë mjaft të përhapura metodat që stimulojnë procesin e të nxënit me nxitjen e pjesëmarrjes aktive të studentëve dhe strukturimit të ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Përdorimi i metodave të tilla është konstatuar në syllabuset e lëndëve dhe është konfirmuar si nga stafi ashtu dhe nga studentët. Këta të fundit janë mjaft të kënaqur me këto metoda si instrumenta që nxisin interesin dhe stimulojnë procesin e të nxënit. Metodatat e aplikuara dhe të vërtetuara gjatë vizitës dhe takimit me stafin dhe studentët janë të shumëllojshme ku disa prej tyre renditen më poshtë:

Puna në grup. Gjatë orëve të seminareve, punëve praktike apo studiove, zhvillohen detyra, ushtrime apo pune në grupe. Kjo metodë, përveçse nxit aftësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe dijeve, simulon dhe kontekstin real të punës duke kontribuar në mësimin dhe ambjentimin e të punuarit në skuadër si dhe të kuptuarit të roleve individuale brenda një grupit.

Prezantimet / ekspozimet publike. Duke qënë se një pjesë e madhe e lëndëve/moduleve kanë si komponent të mësimin apo vlerësimit detyrat apo projektet, dorëzimi i tyre bëhet përmes prezantimeve publike para studentëve të tjerë apo dhe „kritikëve“ të ftuar. Kjo metodë ndihmon në fitimin e aftësive komunikuese në prezantimet publike, e njohur si një komponent i rëndësishëm për një karriere të suksesshme profesionale por dhe për rritjen e efikasitetit në diseminimin e punëve specifike.

Forumet e Hapura. Këto konsistojnë në leksione ose prezantime studimesh, kërkimesh, projektesh apo eksperiencash nga ekspertë të ndryshëm, të shoqëruara me diskutime të hapura me pjesëmarrësit. Integrimi i forumeve të hapura si pjesë e proceseve të mësimdhënies janë të rëndësishme në pasurimin me informacione shtesë, këndvështrimeve të ndryshme si dhe njohjen me raste aplikative/praktike që ndihmojnë në perceptimin më të mirë të aspekteve teorike.

Vizitat studimore. Janë një instrument i rëndësishëm i kombinimit të mësimdhënies në auditor me ato jashtë auditorit, të teorisë me praktikën, duke garantuar kontakte të vazhdueshme me realitetin. Në programin Bachelor në Studime Mjedisore, të vërtetuar si në raporte ashtu dhe nga studentët apo materialet e publikuara në web apo rrjetet sociale të institucionit, organizohen dhjetëra aktivitete në formën e vizitave studimore apo në terren si pjesëmarrje në turne natyrore, vizita në parqe dhe rezervate natyrore, vizita në impiante teknologjike, laboratore, institute, vizita për marrje mostrash, etj.

Sa i përket integrimin të metodologjive të ndryshme dhe alternative të mësimdhënies, GVJ i gjykon ato tejet pozitive e të rëndësishme dhe sugjeron nxitjen e përdorimit sa më të gjerë të tyre.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (*Në Aneks: Tabela 14. Format mësimdhënies në programin BSc në Studime Mjedisore*):

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyra
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj.

Përveç anës teorike, pra të leksioneve, të çdo lënde/moduli, të gjitha lëndët/modulet kanë në përmajtjen e tyre edhe forma të tjera të mësimdhënies. praktikën si një element kyç në përvetsimin e dijeve. Organizimi i mësimdhënies bëhet përmes oreve të leksionit, seminarëve, orëve studio/projekte, praktikave mësimore dhe pune laboratorike si dhe praktikave profesionale. Me rritjen e kapaciteteve laboratorike të Universitetit, një pjesë e oreve të praktikës zhvillohen edhe si pune laboratorike që për shkak të profilit të studimeve konsiderohen dhe si orë pune në studio/projekte.

Nga shqyrtimi i planeve mesimore dhe i të dhënave të ngarkesës totale në auditor sipas formave të mësimdhënies të programit të studimit Bachelor në Studime Mjedisore, rezulton që leksionet zënë një pjesë të mirë të kësaj ngarkese, rreth 46% (833 orë). Kjo mund të konsiderohet mëse normale duke patur parasysh ciklin dhe profilin specifik të këtij programi. Ndërkohë seminarët zënë rreth 27% (496 ore) të ngarkesës në auditor duke krijuar një balancë mjaft të mirë me aspektin më praktik të laboratorëve (në formë studio/projekte) që zënë rreth 22% të ngarkesës, e plotësuar me një 5% si praktikë profesionale. Kjo shpërndarje gjykojmë që është në përputhje me udhëzimet dhe me objektivat e programit të studimit.

Format e kontrollit të njohurive (*Në Aneks: Tabela 15. Format e kontrollit të njohurive*)

Format e kontrollit të njohurive që aplikohen përgjithësisht në Universitetin POLIS janë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve të kursit (laboratorike, detyra kursi, projekteve, etj.), testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.

Vlerësimi i studentëve bëhet bazuar në disa komponentë duke mënjeluar përjashten tradicionale të vlerësimit vetëm në një provim final. Vlerësimi, bazuar në kombinimin e performancës në detyra /projekte, testime të pjesshme, provim final dhe frekuentim, bën të mundur kontroll më të plotë të formimit të studentit dhe të

shtrirë gjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës si rezultat i ponderuar i disa elementëve, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, duke stimuluar kështu dhe një angazhim më konstant e të vazhdueshëm të studentëve. Raportet dhe peshat specifike të formave të kontrollit të njohurive variojnë në përputhje me natyrën e lëndës (p.sh laboratorët i venë peshë më të madhe plotësimit të detyrimeve ndërkohë një lënde teorike më shumë provimit përfundimtar). Vihet re që peshën më të madhe e zënë plotësimi i detyrimeve dhe provimi përfundimtar me peshë respektivisht nga 30-60% dhe 20-60% të totalit prej 100%. Ndërkohë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive ngelen gjithmonë me një peshë konstante prej 10% të vlerësimit të përgjithshëm duke pasur gjithashtu një karakter pengues të kalimit në rast mosprezence.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësive etj

Bazuar në materialet e DVV, takimeve me njësitet drejtuese të institucionit, me stafin akademik dhe studentët si dhe nga shqyrtimi i raporteve të aktiviteteve dhe projekteve shkencore/të aplikuara apo publikimeve të bëra, u konstatua që ka një angazhim aktiv të studentëve në aktivitetet e njësive.

Mënyrat e evidentuara të angazhimit janë të shumëfishta dhe shkojnë nga pjesëmarrja e thjeshtë me prezencë deri te zhvillimi i punëve kërkimore si pjesë e një grupi apo në forma publikimesh artikujsh shkencorë. Është natyrisht mëse e kuptueshme që sa më i lartë cikli i studimeve aq dhe më i madh është angazhimi i studentëve në aktivitete të tilla. E thënë kjo, nga biseda me studentët u verifikuan një sërë faktesh të paraqitura në raportin e vlerësimit të brendshëm në lidhje me angazhime konkrete të studentëve të PS Bachelor në Studime Mjedisore.

GVJ konstaton pjesëmarrje me prezencë të thjeshtë në dhjetëra aktivitete të organizuara nga Universiteti POLIS si “Javët e Tokës”, Ekspozita “Jo Plastikës”, prezatime mbi mbetjet e ngurta urbane dhe cilësisë së ajrit të brendshëm në shkollat e mesme, vizita studimore, etj. Në mënyrë të veçantë janë për t’u përmendur pjesëmarrja me prezencë dhe me punime/paper-a në Konferencën e Parë Studentore të Universitetit POLIS (KSUP 2017) me temë “Mjedisi dhe Planifikimi Urban në Këndvështrimin Studentor” dhe në Konferencën e Dytë Studentore të Universitetit POLIS (KSUP 18) me temë “Mjedisi dhe Zhvillimi i Qendrueshëm”. Punimet e tyre janë të dokumentuara dhe të publikuara në numrin special të revistës HABITAT, konkretisht HABITAT Magazine 5, Sustainable Development and Environmental Issues. Revista i është dhënë GVJ gjatë vizitës në institucion.

Nuk mungojnë dhe rastet ku studentët kanë qënë të angazhuar në asistencën e pedagogëve për zhvillimin e punimeve shkencore ose në projekte Kërkimi të Aplikuara sic është rasti “100 Fshatrat”, menaxhuar nga AKPT apo përfshirja, siç është deklaruar gjatë takimit me studentët, në aktivitete, projekte dhe studime të Co-Plan për shërbimet publike mjedisore, për pellgjet ujëmbledhëse.

Në përgjithësi angazhimi i studentëve në aktivitetet e njësive është shumë i mirë dhe siç u theksua më herët, është gjithmonë në rritje në ciklet më të larta të studimit. Në anekset e këtij raporti, (Tabela 16. Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësive (2017-2018) gjenden të dhëna më të detajuara të aktivizimit të studentëve.

GVJ gjykon që dhe pse kapaciteti dhe njohuritë gjatë ciklit të parë të studimeve janë jo shumë të mëdha për t’u angazhuar në projekte apo aktivitete të mirëfillta shkencore, në rastin konkret shihet një aktivizim mjaft i mirë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni i vënë në dispozicion me DVV ishte mëse i mjaftueshëm për zhvillimin e analizave, ndërkohë gjatë vizitës në institucion janë marrë planet mësimore dhe një sërë materialeve statistikore si dhe është vërtetuar përmbajtja e të dhënave si dhe konfirmuar nga ana e stafit apo studentëve. Kjo i referohet materialeve si syllabuse, rregullore, planeve mësimore, etj.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi në Programin Bachelor në Studime Mjedisore bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Universiteti POLIS ka një procedurë të mirëpërcaktuar të seleksionimit të kandidatëve (të sanksionuar dhe në vetë rregulloren e programit specifik) nëpërmjet një testi pranimi në bazë të konkurimit/klasifikimit brenda numrit të miratuar të kuotave si dhe notës mesatare të fituar në shkollë të mesme. Procesi përzgjedhës bazohet tek merita dhe konsiston në një test me shkrim që bazohet në njohuritë e fituara në shkollën e mesme, kulturën e përgjithshme dhe njohuritë specifike në fushën e mbuluar nga programi i studimit.

Institucioni ka një përkujdesje të veçantë për informimin sa më të plotë të tyre në lidhje me programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij.

Institucioni zhvillon dhe përditëson vazhdimisht Guidën e Studentit brenda së cilës gjenden informacione të përgjithshme mbi vizionin dhe shërbimet e ofruara nga Institucioni si dhe lidhje të rëndësishme për procedurat e regjistrimit, transferimit, programet, etj. Përveç sa më sipër, studentët kanë mundësi të marrin informacione të rëndësishme mbi jetën dhe aktivitete kulturore e sociale në institucion (me anë të Broshurës së Aktiviteteve) si dhe informacione përsa i përket orientimit në tregun e punës me anë të Broshurës së Alumni dhe materialeve tek ZMSKK. Në çdo rast është verifikuar që të gjitha materialet dhe informacionet e duhura mbi programet e studimit janë lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare ne web-in e Universitetit.

Në fakt informimi dhe orientimi i studentit është një proces që vijon gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve dhe më tej, kjo falë Shërbimit të Këshillimit të Karrierës përmes veprimtarisë së Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë luan një rol të rëndësishëm në njohjen e studentit me tregun e punës, si me transmetimin e informacioneve ashtu dhe me lehtësisrat e gjetjes dhe kryerjes së praktikave profesionale apo ku është e mundur dhe lehtësimin e procesit të punësimit.

Çdo student ka një akses personal në portalin online ku mund të marrë të gjitha informacionet e duhura mbi programin e studimit, lëndët, syllabuset, etj. Ky portal shërben dhe për vlerësimin e pedagogëve në cdo lëndë. Vlerësimi është anonim. Nga të dhënat rezultojnë që ka 50 % të peshës specifike të vlerësimit të pedagogëve, çka tregon për rëndësinë që ka studenti në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Përsa i përket kushteve dhe ambjenteve të vëna në dispozicion të studentëve, mund të thuhet që përmbushin standartet më të larta. Universiteti është i pajisur më të gjitha instrumentat dhe hapësirat e duhura për të garantuar një mësimdhënie cilësore. Nga bisedat në institucion rezultojnë që studentët kanë akses 24 orë në ambjentet e institucionit, akses i cili zakonisht „shfrytëzohet“ përgjithësisht gjatë sezoneve të provimeve. Institucioni ofron gjithashtu transport falas për studentët e tij duke vënë në dispozicion mjete transporti për ardhjen në mëngjes dhe kthimin në fund të procesit mësimor.

Një vëmendje e veçantë tregohet dhe në integrimin e studentëve në aktivitetet që njësitë përkatëse organizojnë shpesh herë dhe në angazhimin e tyre në tema dhe projekte konkrete në terren. Dimensionin ndërkombëtar i institucionit dhe marrëveshjet e gjera të bashkëpunimit ndikon pozitivisht në formimin e studentëve si dhe në rritjen e mundësive të mobilitetit apo dhe integrimin në tregun e punës.

Nga takimi i bërë me studentët gjatë vizitës së GVJ në institucion është konstatuar që ka një nivel shumë të lartë kënaqësie dhe vlerësimi nga ana e studentëve përsa i përket ambjenteve, laboratorëve, mësimdhënies, gatishmërisë së stafit akademik dhe administrativ si dhe jetës shumë të pasur kulturore që organizohet nga institucioni.

Si përfundim mund të themi që institucioni është i angazhuar plotësisht në krijimin e një atmosfere dhe kushteve optimale për studentët e pranuar.

Studentë aktivë përfshirë studentët e prapambetur të riaktivizuar përt vitin akademik aktual është si më poshtë:

Viti akademik 2016-2017 – 11 studentë

Viti akademik 2017-2018 – 13 studentë

Viti akademik 2018-2019 – 9 studentë

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Gjithsesi procedurat e pranimit të studentëve janë të mirëpërcaktuara në "Politikat e pranimit të studentëve apo në nenet e Rregullores Mësimore të Programit të Studimit Bachelor në Studime Mjedisore dhe më konkretisht:

- Neni 6. Kerkesat per pranimin ne programin e studimeve Bachelor
- Neni 7. Shpallja dhe publikimi i informacionit per konkurim ne programin Bachelor
- Neni 8 . Kriteret e pranimit ne programin Bachelor
- Neni 9. Procesi i perzgjedhjes dhe testi i pranimit

Ndërkohë që procedura e pranimit është e detajuar në mënyrë të hollësishme si më lart, po listojmë pikat e Nenit 8 të Rregullores ku jepen kriteret e pranimit në programin Bachelor në Studime Mjedisore, ku shprehet se lejohen që të ndjekin studimet në këtë program ata kandidatë që:

8.1 Kanë fituar diplomë sipas pikes 6.1 [maturën shtetërore ose zotërojnë një diplomë ekuivalente studimi të fituar në vende të tjera të njohura nga autoritet zyrtare dhe ligjet në fuqi] ose ekuivalente me to, sipas akteve në fuqi, dhe kanë mesatare të ponderuar të notave të studimit kundrejt pikëve maksimale sipas kriterëve të përcaktuara nga U_POLIS.

8.2 Janë fitues në konkurimin midis kandidatëve aplikantë brenda kuotave të pranimit të paracaktuara çdo vit nga universiteti, të cilat shpallen në mjediset e dukshme të universitetit dhe në website-in e shkollës në internet, jo më vonë se 1 javë para fillimit të studimeve.

8.3 Pranohen në këtë Bachelor në bazë të konkurimit/klasifikimit brenda numrit të miratuar të kuotave, referuar një procesi përzgjedhës që bazohet tek merita e profesionalizimi, dhe të shpallur në websitin e U POLIS. Mosregjistrimi ose mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në afatin e paracaktuar nënkupton skualifikimin. Në këtë rast ose në rast tërheqje të kandidatëve të kualifikuar, përfiton kandidati i parë në listën pritëse.

8.4 Studentët e regjistruar në programin Bachelor në SM të U_POLIS nuk mund të jenë ose të regjistrohen më pas njëkohësisht në programe të tjera Bachelor.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia në hyrje e studentëve është mesatare, ndërkohë që është e dukshme që mesatarja në hyrje ka ardhur duke u përmirësuar ndër vite duke pasur një rritje të asaj të parës në vitin akademik 2011-2012 me të fundit të vitit 2018-2019 me pothuajse 1 notë më lartë (duke arritur rreth 7.5 çka mund të konsiderohet gjithsesi në kufijtë e mbi mesatare). Arsytet mund të jenë të kuptueshme pasi bëhet fjalë gjithsesi për një program studimi relativisht të ri në tregun shqiptar por mesatarja në rritje në vitet e fundit dhe angazhimi i Universitetit në këtë fushë si dhe potencialet që ka si program në tregun e punës, bazuar në strategjitë kombëtare mendojmë që do ndikojnë pozitivisht në përthithjen e studentëve me mesatare akoma më të lartë. Ndërkohë mesatarja në dalje mbetet në nivele të përafërta me atë në hyrje çka reflekton një vlerësim korrekt dhe në sintoni me kapacitetet e studentëve në hyrje.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Në bazë të dhënave të marra në institucion, rezulton se numri total i studentëve të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë) që nga viti akademik 2012-2013 e deri më sot është 120. Një listë më e detajuar e numrit

të studentëve të regjistruar dhe që kanë përfunduar studimet në programin BSc në Studime Mjedisore gjatë 2011-2018 gjendet në Aneks të këtij raporti. (Tabela 17).

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse).

Nga të dhënat e shqyrtuara, rezulton që në vitin e fundit (pra të diplomuarit e regjistruar në vitin akademik 2015-2016) janë diplomuar 16 studentë (nga 23 të regjistruar për herë të parë) me mesatare të përgjithshme 6.97.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nga të dhënat e dorëzuara nga sekretaria mësimore, rezulton se që nga hapja e programit ka pasur 18 studentë të transferuar nga programe/institucione të tjera.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Nga deklaratimet e bëra mbi të dhënat e punësimit për studentët e Bachelor në studime mjedisore, rezulton se mbi 70% e studentëve janë të punësuar pas diplomimit. Pjesa më e madhe rezulton të jetë e punësuar në sektorin publik ose privat (mbi 95% e të punësuarve) por ka dhe raste vetëpunësimi. Në aneksin e këtij raporti gjendet Tabela 18. Të dhëna për punësimin e të diplomuarve në BSc në Studime Mjedisore”

Numri total të diplomuarve

Nga të dhënat e shqyrtuara rezulton se numri total i të diplomuarve është 46

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Nga të dhënat e shqyrtuara rezulton se numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën) është 25.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Nga të dhënat e shqyrtuara rezulton se numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën) është 19.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion janë verifikuar të dhënat e DVV si dhe janë marrë statistikatat e studentëve

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Universiteti POLIS ka një procedurë të qartë pranimi dhe seleksionimi të kandidatëve nëpërmjet testeve specifike për programet e ndryshme të studimit. Programi Bachelor në Studime Mjedisore ka një test pranimi në bazë të konkurimit/klasifikimit brenda numrit të miratuar të kuotave. Proçesi përzgjedhës bazohet tek merita dhe konsiston në një test me shkrim që bazohet në njohuritë e fituara në shkollën e mesme, kulturën e përgjithshme</p>

	dhe njohuritë specifike në fushën e mbuluar nga programi i studimit si dhe mesatarja e notës së fituar në shkollën e mesme.
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët kanë një informim të gjerë për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Së pari atyre u jepet „Guida e Studentit“ dhe „Broshura Alumni“ ku jepen informacione mbi strukturën institucionale, ofertën akademike, rezultatet e të nxënit dhe orientimit në tregun e punës.</p> <p>Në këto dokumente përfshihen detaje të kurrikulës akademike, kritereve dhe kushteve që studentët duhet të plotësojnë, kushtet për kalimin nga një vit në tjetrin, përvojat e pënësimit etj.</p> <p>Studentët vlerësojnë pedagogun në cdo lëndë. Vlerësimi bëhet nëpërmjet sistemit online dhe është anonim. Vlerësimi bëhet nëpërmjet një formulari të zhvilluar nga NJBSC përpara përfundimit të lëndës dhe nga të dhënat rezulton që ka 50 % të peshës specifike të vlerësimit të pedagogëve.</p> <p>Shërbimi i këshillimit të karrierës bëhet i mundur dhe përmes ngritjes, funksionimit dhe veprimtarisë së Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës me detyre kryesore informimin e studentëve përpara dhe gjatë ndjekjes së studimeve, si dhe njohjen paraprake me tregun e punës, orientimin e tyre në këtë treg si dhe ndërmjetësimi e lehtësimin e kontakteve me te.</p> <p>Gjithashtu, në raportin e Alumni, i cili i jepet dhe studentëve, gjenden të dhënat e punësimit të secilit prej tyre duke i kontaktuar ata nëpërmjet e-mailit apo edhe nëpërmjet bisedave apo takimeve, duke krijuar kështu edhe database i cili rinovohet me të dhëna cdo vit.</p>
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe verifikimi në Sekretarinë Mësimore të Universitetit POLIS rezulton se çdo student ka një dosje të tij personale. Gjithashtu informacioni i plotë për çdo program studimi, është i ruajtur në hard copy dhe në mënyrë elektronike. Ky i fundit ka një siguri akoma më të madhe nëpërmjet sistemit të backup.</p> <p>Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me regjistrimet e studentëve, transferimet, çregjistrimet e tyre si dhe diplomimin. Këto statistika dërgohen në drejtorinë e Statistikave në MAS, njëkohësisht edhe Departamentit përkatës, i cili është përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Vlerësimet/notat e studentëve ruhen elektronikisht (regjistri elektronik i notave), njëkohësisht plotësohet edhe regjistri fizik i notave.</p>
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre	Per këshillimin e studentëve lidhur me ecurinë e procesit akademik funksionon shërbimi i tutoratit, që zakonisht ofrohet nga

dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

menaxherët e kurrikulës. Një rol të rëndësishëm për këtë luan Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës.

Siç dhe u përmend më parë, Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës përveç informimit të studentëve përpara dhe gjatë ndjekjes së studimeve ka dhe si detyre informimin për njohjen paraprake me tregun e punës dhe ndërmjetësimin e lehtësimin e procesit të zhvillimit të praktikës së tyre profesionale. Janë konstatuar dhe mundësitë e kryerjeve të praktikave profesionale nëpërmjet dy partnerëve strategjikë të Universiteti POLIS, pra Co-PLAN e Metro_POLIS, por dhe nëpërmjet rrjetit të partnerëve.

Konkluzionet e vlerësimit të plotësimit të standarteve/kritereve për rubrikat 8 dhe 9:

1. Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj. Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Universiteti POLIS ka një procedurë të qartë pranimi dhe seleksionimi të kandidatëve nëpërmjet një testi pranimi. Numri i të pranuarve kushtëzohet nga numri i miratuar i kuotave hyrëse të përcaktuara për çdo PS nga Institucioni.
3. Studentët kanë një informim të gjerë për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, detaje të kurrikulës akademike, kritereve dhe kushteve që studentët duhet të plotësojnë, kushtet për kalimin nga një vit në tjetrin etj. Informimi bëhet nëpërmjet kanaleve të shumëfishta, si Guida e Studentit, Raporti Alumni, kontratat që lidhin me institucionin, portale dhe faqet web, portali i studentit, etj.
4. Studentët vlerësojnë pedagogun në cdo lëndë nëpërmjet sistemit online me anonimitet të plotë. Vlerësimi i studentëve ka 50 % të peshës specifike të vlerësimit të pedagogëve.
5. Shërbimi i këshillimit të karrierës bëhet i mundur përmes Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, me detyre kryesore informimin e studentëve përpara dhe gjatë ndjekjes së studimeve, si dhe njohja paraprake me tregun e punës, orientimin e tyre në këtë treg dhe ndërmjetësimin e lehtësimin e punësimit aty ku është e mundur.
6. Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të të gjitha cikleve, përfshirë atë të parë.
7. Nga vizita në institucion dhe verifikimi në Sekretarinë Mësimore të Universitetit POLIS rezulton se çdo student ka një dosje të tij personale.
8. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me regjistrimet e studentëve, transferimet, çregjistrimet e tyre si dhe diplomimin. Këto statistika dërgohen në drejtorinë e Statistikave në MAS, njëkohësisht edhe Departamentit përkatës. Vlerësimet/notat e studentëve ruhen elektronikisht (regjistri elektronik i notave), njëkohësisht plotësohet edhe regjistri fizik i notave.
9. Institucioni disponon të dhëna të plota për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim dhe e gjithë databaza është si në *hard copy* dhe elektronike, përfshirë dhe një sistem *back-up*.
10. Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve. Kjo bëhet e mundur përmes shërbimit të tutoratit, që zakonisht e ofrojnë menaxherët e kurrikulës, si dhe Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës. Kjo e fundit ka një rol të rëndësishëm dhe në informimin e studentëve mbi tregun e punës si dhe ndërmjetësimin e lehtësimin e procesit të zhvillimit të praktikës së tyre profesionale.
11. GVJ ka konstatuar dhe mundësinë e kryerjeve të praktikave profesionale nëpërmjet dy partnerëve të strategjikë të Universiteti POLIS, pra Co-PLAN e Metro_POLIS.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimit shkencor bazuar në metodat bashkëkohore dhe inovative përbën një nga objektivat kryesore të Universitetit POLIS.

Sic shprehet në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, Universiteti POLIS synon të pozicionohet si një epiqendër rajonale, që gjeneron debat mbi çështjet themelore mjedisore dhe zhvillimin urban me të cilat përballen shoqëritë bashkëkohore urbane në nivel global dhe, në veçanti, në kontekstin tonë lokal.

Institucioni harton në mënyrë periodike Axhendën e Kërkimit Shkencor (dokument prej 15 faqesh i vënë në dispozicion të GVJ) ku në plotësim të Strategjisë së Zhvillimit të institucionit, detajohen fushat e interesit të kërkimit shkencor sipas fakulteteve dhe departamenteve. Ky dokument përbën bazën e politikave të kërkimit shkencor në institucion dhe hartohet nga autoritetet dhe organet drejtuese, në fillim të çdo viti akademik. Ky dokument vjen dhe si rezultat i një sesioni reflektimi/workshop me pjesëmarrjen e të gjithë stafit akademik. Ky fakt është vërtetuar si nga takimet me njësitë drejtuese dhe stafin ashtu dhe nga materiali fotografik, ftesat dhe axhendat e eventit të vëna në dispozicion të GVJ.

Gjykojmë që organizimi i nje eventi të tillë dhe disponimi i dokumentacionit përkatës ndihmon në menaxhimin më të saktë të procesit të kërkimit dhe prioriteteve, krijimin e një sintonie dhe efikasiteti ndërmjet interesave personale të stafit për kërkim dhe atyre të institucionit, lidhjen më të mirë ndërmjet procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit duke sjell një pasurim reciprok dhe së fundmi, jo më pak e rëndësishme, pasja e një tabloje transparente të kërkimit dhe stimulimit të ndërveprimit ndërmjet stafit akademik.

Ka evidenca të qarta, të konfirmuara nga takimi me stafin, që Universiteti POLIS nxit dhe mbështet kërkimin shkencor të personelit akademik nëpërmjet programeve të brendshme, programeve të përbashkëta, projekteve ndërkombëtare, konferencave dhe aktiviteteve shkencore dhe financimeve direkte. Nga verifikimet e bëra dhe pranë Zyrës së Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, konstatohet që stafi akademik ka të mirëpërcaktuar në kontratat e tij, në anekse të posaçme, ndarjen dhe kontributin e tij si në aspektin e mësimdhënies ashtu dhe në atë të kërkimit, duke u bërë kjo dhe një instrument ballafaqimi mbi performancën dhe impenjimet e marra nga të dyja palët.

Një nga aspektet më të rëndësishme është dhe fakti që rezultatet e kërkimit shkencor vlerësohen nga institucioni nëpërmjet një sistemi të mirëpërcaktuar me 36 kriteretipologji aktivitetesh ku secila mban një peshë specifike. Çdo vit krijohen raporte mbi ecurinë dhe performancën në nivel personal, departamenti dhe fakulteti dhe institucioni duke dhënë kështu një produkt të prekshëm të aktivitetit kërkimor dhe zhvillimor. Është konstatuar gjithashtu që Universiteti POLIS ka një shpërndarje mjaft të mirë të aktivitetit të tij shkencor falë publikimeve të librave të ndryshme e, në mnyrë të veçantë, periodikëve shkencor të vetë Universitetit si Forum A+P apo inserteve si MAD Magazine apo HABITAT. Gjykojmë që ky fakt kontribon gjithashtu në rritjen e kapacitetit kërkimor në vend, në fushat e mbuluara nga POLIS, ashtu dhe në përditësimin e përmirësimin e mësimdhënies.

Kërkimi është një proces gjithëpërfshirës dhe i zhvilluar nga të gjitha njësitë në POLIS por duhet theksuar fakti që në çdo Fakultet njësia e tretë është një njësi e lidhur ngushtë me Kërkimin. Konkretisht në Fakultetin e Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban (FPMMU), ku ofrohet Programi i Studimit Bachelor në Studime Mjedisore, njësia e tretë përveç Departamentit të Mjedisit dhe Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit Urban është pikërisht Njësia Kërkimore e Qëndrueshmërisë (Sust_Lab). Angazhimi dhe pozita e FPMMU duket mjaft e favorshme në kuadrin e pergjithshëm të kërkimit shkencor të institucionit pasi tematika kryesore, e cila shërben si referencë për projektet e veçanta kërkimore, kryesisht ato të doktoratës, është Qëndrueshmëria (Sustainability). Për t'u përmendur së fundmi është dhe një përjasje

kërkimi në nivel ndër-departmental, e koordinuar nga Innovation Factory (konstatuar si gjatë takimit me këtë njësi dhe nga anekset e DVV), një njësi "crosscutting" që zhvillon e promovon projekte duke bashkërenduar procesin e kërkimit shkencor shpesh me atë të aplikuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Bazuar në deklarin e institucionit si dhe në verifikimet e kryera gjatë vizitës në institucion rezultojn se institucioni është shumë i perkushtuar ndaj kërkimit shkencor në të gjitha nivelet, stafi individualisht, departamentet por dhe në nivel ndër-departmental siç u konstatua dhe gjatë takimit me Innovation Factory. Kërkimi shkencor dhe ai i aplikuar kryhet nëpërmjet një morie aktivitetesh si konferenca shkencore kombëtare, ndërkombëtare dhe institucionale, workshope të ndryshme, simpoziume, kongrese, seminare, projekte kërkimore, projekte zhvillimore, publikime, etj.

Vizita në institucion konfirmoi dhe aktivitetin e gjerë e të larmishëm botues (si tekste mësimore, libra, monografi, artikuj shkencorë dhe periodikë (Forum A+P, MAD Magazine, HABITAT).

Nga shqyrtimi i të dhënave konstatohet numri i lartë i botimeve në formën e artikujve (783 në një periudhë pesëvjeçare) si dhe punimet dhe prezantimet shkencore (685 po për të njëjtën periudhë). Jo më pak i rëndësishëm është publikimi i monografive (57). Ndërkohë institucioni rezultojn pjesëmarrës/fitues i një morie projektesh kërkimore/zhvillimore (16) dhe organizimi i 19 aktiviteteve shkencore nga të cilat më shumë se gjysma ndërkombëtare. Si rezultat i sasive të larta në aktivitete kërkimore dhe zhvillimore, konstatohet që dhe pjesëmarrja e studentëve është në nivele shumë të larta. Më shumë të dhëna mund të gjenden në Anekset e këtij raporti (Tabela 19. Të dhëna për kërkimin shkencor në Universitetin POLIS, 2013-2017)

Performanca e Departamentit të Mjedisit (pranë FPMMU), përgjegjës i programit të Studimit Bachelor në Studime Mjedisore është po aq e lartë sa e institucionit. Vihet re një angazhim i gjerë në botime (mbi 40 në dy vitet e fundit) si dhe një numër i lartë i pjesëmarrjeve në konferenca (mbi 30 në po të njëjtën periudhë) si dhe publikimi i librave dhe pjesëmarrja në projekte. Më shumë të dhëna mund të gjenden në Anekset e këtij raporti (Tabela 20. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës të Departamentit të Mjedisit, viti akademik 2017-2018).

Të dhënat mbi veprimtarinë kërkimore regjistrohen, mbahen dhe arkivohen nga Departamentet, Fakultetet, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë etj sipas specifikave dhe, të gjitha grupohen në një Raport mbi Kërkimin Shkencor (i verifikuar "Raport mbi Kërkimin Shkencor në Universitetin POLIS 2013-2017"). GVJ vlerëson që Universiteti POLIS ka një aktivitet të gjerë kërkimor dhe një sistem shumë të mirë nxitjeje, koordinimi, promovimi dhe diseminimi të tij, pa harruar dhe një element tejet të rëndësishëm siç është dimensionin ndërkombëtar i kërkimit (falë programit ndërkombëtar të doktoraturës apo organizmi i konferencave dhe publikimeve ndërkombëtare në gjuhë të huaj).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion janë verifikuar të dhënat e DVV si dhe janë marrë dokumenta përfundimtare si sistemi i vlerësimit të kërkimit shkencor, botime që vërtetojnë projektet kërkimore, aktivitetet shkencore dhe publikimet. Gjithashtu janë marr prova në lidhje me "workshopin" vjetor të kërkimit (foto, ftesa, strategji, etj.)

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Universiteti POLIS, siç paraqitet dhe në analizën SWOT të RVB, është një institucioni i cili karakterizohet nga një dimensioni i spikatur ndërkombëtar. Larmshmëria dhe sasia e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe të partneritetit me IAL vendase dhe të huaja, institucione qeveritare, organizata profesionale publike dhe private, komunitetin e biznesit dhe organizma/shoqata ndërkombëtare kanë mundur që Universiteti POLIS të zhvilloj një portfolio të pasur me aktivitete të kryera në bashkëpunim me partneret.

Në mënyrë të veçantë evidentohen 14 projektet kërkimore/zhvillimore për ngritjen e kapaciteteve (multilaterale dhe bilaterale) të financuara nga BE.

Vlen për t'u përmendur në mënyrë të veçantë projekti, tashmë i përfunduar, TEMPUS "DAPEEWB" i koordinuar nga Universiteti POLIS, duke qenë dhe hera e parë që një IAL shqiptar koordinon një projekt të tillë. Jo më pak të rëndësishme ishin dhe projekti TEMPUS "CONSUS" me një kontribut të veçantë në zhvillimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe projektit Erasmus + KA2 "QAinAL" me një kontribut të veçantë në Sigurimin e Cilësisë.

Evidentohet gjithashtu një bashkëpunim i ngushtë me një sërë aktorësh lokalë si nga institucionet publike ashtu dhe organizata profesionale ku, në bashkëpunim me to, janë zhvilluar një sërë projektesh si plane territoriale, politika zhvillimit, plane lokale, etj.

Gjykojme që një bashkëpunim kaq i gjerë dhe i diversifikuar ndikon pozitivisht në zhvillimin e programeve të studimit, stafit, studentëve, institucionit në përgjithësi dhe të vetë shoqërisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
Në bazë të shqyrtimit të të dhënave, rezultojnë që Universiteti POLIS nga viti 2013 deri në vitin 2018 ka qënë pjesëmarrës në 23 projekte bilaterale ose multilaterale të tipit TEMPUS, H2020, Erasmus + KA2, CREATIVE EUROPE, bilaterale të AKTI, Erasmus + KA1, etj. Më shumë të dhëna mund të gjenden në Aneksin e këtij raporti (Tabela 21. Të dhëna mbi projektet Bi/Multilaterale ku U_POLIS është partner ose drejtues). Përfitimet rezultojnë të kenë qënë të shumfishta. Së pari këto projekte kanë ndikuar pozitivisht në kualifikimin e stafit në kuadër dhe të shkëmbimit (mobilitetit) ku, siç raportohet, kanë lëvizur drejt universiteteve partnere 104 anëtarë të stafit akademik dhe administrativ të POLIS, si dhe POLIS ka pritur 83 anëtarë të stafit akademik dhe administrativ nga universitetet europiane. Në nivel studentësh raportohet që rreth 52 studentë, nga të cilët 16 të Programit PhD, kanë qënë pjesë e skemave të mobilitetit.

Në nivel institucional, siç u përmend dhe më herët, aktiviteti shkencor ka ndikuar pozitivisht në rritjen e kapaciteteve, trajnimin për përdorimin e metodologjive të mësimdhënies, rritjen e sigurimit të cilësisë por, mbi të gjitha, në angazhimin konkret në projekte zhvillimore dhe kërkimore duke nxitur kështu kërkimin dhe publikimin.

Për t'u përmendur si një aspekt i rëndësishëm së veçantë, kryesisht dhe për Programin Bachelor në Studime Mjedisore, është dhe financimi dhe ngritja e Laboratorit të Eficencës dhe e Laboratorit të Mjedisit i cili solli një stimul pozitiv si në procesin e mësimdhënies e mësimnxënies (vërtetuar nga takimet me stafin dhe studentët) ashtu dhe në zhvillimin e kërkimit shkencor apo projekteve të aplikuara. Së fundmi, konstatohet që falë këtyre projekteve, është pasuruar biblioteka me një literaturë bashkëkohore dhe cilësore.

Të gjitha këto vërtetojnë mësimin nivelin e lartë të bashkëpunimit ndërkombëtar të institucionit si dhe kontributin tejet pozitiv që ka sjell ky bashkëpunim në zhvillimin e programeve të studimit, stafit, studentëve dhe institucionit në tërësi, i konfirmuar dhe nga bashkëpunimi ndërkombëtar në ofrimin e programeve të studimit në nivel masteri me Universitetin Ipag (Francë) apo Universitetin Erasmus (Holand) si dhe në nivel doktrature me anë të programit të Përbashkët Ndërkombëtar të Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës, Itali.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso dhe natë në aneks)

Pjesëmarrja e Universitetit POLIS në një numër të madh projektsh ndërkombëtare ndihmon në lidhjen e marveshjeve dhe të partneritetit me një numër të madh IAL si kombëtare ashtu dhe Ndërkombëtare. Një bashkëpunim shume i mirë evidentohet dhe me institucione qeveritare, ku nga raporti listohen mbi 20 partnerë nga kjo fushë. Bashkëpunimi me këto institucione fokusohet përgjithësisht në zhvillimin e projekteve si plane territoriale, politikat zhvillimit, monitorime mjedisore apo plane lokale për të cilat ka evidenca të mjaftueshme. Ndërkohë që, bazuar dhe në takimet me njësitë e ndryshme e në veçanti me ZMSKK, bashkëpunimi me organizata profesionale dhe me komunitetin e biznesit (rreth 30 së bashku) është shumë i vlefshëm jo vetëm për praktikën profesionale të studentëve por dhe për të marrë vazhdimisht feedback nga tregu i punës, si dhe për të lehtësuar punësimin e studentëve. Një listë më e detajuar e institucioneve dhe organizatave bashkëpunuese gjendet në aneksin e këtij raport (Tabela 23).

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Gjatë vizitës në institucion janë parë, konsultuar e shqyrtuar një sërë dokumentash (marrëveshje bashkëpunimi, statistika projektsh, materiale nga projektet, etj.) dhe ambjentesh (laboraret, biblioteka, etj.) që faktojnë bashkëpunimet, partneritetet dhe projektet e Universitetit POLIS.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Nga takimet e bëra me drejtuesit dhe stafin, rezultojnë se në hartimin dhe mbikëqyrjen e programit kanë një rol parësor njësitë drejtuese por inputet vijnë drejtpërdrejtë nga stafi dhe puna e tyre në grup. Takimet, qoftë informale dhe ato të formalizuara, janë një praktikë e përhapur në POLIS dhe shërbejnë pikërisht për shkëmbim idesh dhe informacionesh mbi zhvillimet akademike të programeve të ndryshme. Fakti më evident është ëorkshopi i përvitshëm ku hartohet në mënyrë thuajse kolegjiale Axhenda Kërkimore, e cila synon integrimin e procesit të kërkimit me atë të mësimdhënies, duke reflektuar kështu influencën dhe impaktin që ka interesi personal kërkimor i stafit me atë të institucionit dhe me programet të cilat ofron.</p> <p>Stafi ka një ndarje detyrash shumë të qartë që konkretizohet në një plan individual, i cili i bashkëngjitet kontratës në formë aneksi. Ky plan dhe kjo ndarje nuk vijnë imponuar nga pjesa drejtuese por si rezultat i një reflektimi, të bërë kryesisht në ëorkshopin e përvitshëm që organizon POLIS me stafin, ku gjithsecili mundohet të balancojë interesat personale me strategjitë e institucionit. Gjatë takimeve me stafin u konfirmua prirja për shkëmbimin e ideve si per pjesën e mësimdhënies ashtu dhe të projekteve kërkimore. Bashkëveprimi vërtetohet edhe nga punët e publikimit e përbashkëta shkencore por dhe nga ekzistenca e Innovation</p>

Factory, njësisë përgjegjëse për koordinimin e projekteve ndërdisiplinore.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;
Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;
Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;
Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Universiteti POLIS ka një numër të konsiderueshëm Marrëveshjesh Bashkëpunimi dhe partneritetesh (rreth 30) me Universitete homologe si të rajonit ashtu dhe evropiane e me tej. Ky fakt reflektohet drejtpërdrejtë në mundësi të mëtejshme të stafit dhe studenteve për të qënë pjesë e mobiliteteve, trajnimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete dhe projekte kërkimi/zhvillimi edhe në nivel ndërkombëtar. Vetë ofrimi i programeve të studimit në nivel masteri me Universitetin Ipag (Francë) apo Universitetin Erasmus (Holand) si dhe në nivel doktrature me anë të programit të Përbashkët Ndërkombëtar të Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës, e bën të prekshme bashkëpunimin dhe përfitimin në terma reale. Universiteti POLIS bashkëpunon ngushtë me komunitetin e biznesit si dhe me institucione publike apo organizatat profesionale (të evidentuara mbi 50 partnerë të këtyre tre kategorive). Këto bashkëpunime shkojnë nga organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve apo projekteve të përbashkëta e deri te zhvillimi i praktikave profesionale për studentët e institucionit. Ky fakt, përtej marrëveshjeve formale, është i verifikueshëm dhe nga formularët/raportet e internshiptit që dorëzohen nga studentët. Gjithashtu zhvillimi i seminareve teknike nga ana e partnerëve apo pjesëmarrja e tyre në projekte të ndryshme, qoftë kërkimi, zhvillimi apo të aplikuar, bën që institucioni të ketë përveç praktikave mësimore të studentëve edhe përfitime në nivel të rritjes së kapaciteteve dhe lidhjes më të mirë me kontekstin real dhe tregun e punës.

Konkluzionet e vlerësimit për plotësimin e standardeve/kritereve të rubrikës 11:

1. Stafi dëshmon një frymë pozitive dhe bashkëpunuese në aktivitetin shkencor, duke e bërë këtë një nga pikat e forta të Universitetit. Ky fakt konfirmohet dhe nga nisma të përbashkëta të personelit në projekte kërkimore/zhvillimor, botime, konferenca shkencore por dhe në ndërveprim njerëzor dhe social.
2. Universiteti Polis me anë të një sërë aktiviteteve nxit një bashkërendim të interesit personal kërkimor të stafit me atë të institucionit dhe me programet të cilat ofron.
3. ~~Ekzistenca e Innovation-Factory, njësi përgjegjëse për koordinimin e projekteve ndërdisiplinore, garanton akoma më shumë marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të Universitetit.~~
4. Universiteti POLIS është një institucioni i cili karakterizohet nga një dimension i spikatur ndërkombëtar dhe kombëtar. Larmishmëria dhe sasia e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe të partneritetit me IAL vendase dhe të huaja, institucione qeveritare, organizata profesionale publike dhe private, komunitetin e biznesit dhe organizma/shoqata ndërkombëtare (mbi 80 në total) kanë

mundësuar që Universiteti POLIS të zhvillojë një portfolio të pasur me aktivitete të kryera në bashkëpunim me partnerët. Vetë ofrimi i programeve të studimit në nivel masteri me Universitetin Ipag (Francë) apo Universitetin Erasmus (Holand) si dhe në nivel doktore me anë të programit të Përbashkët Ndërkombëtar të Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës, dëshmon që institucioni ka një vizion shumë të qartë se si Strategjia e tij e Ndërkombëtarizimit (pjesë e DVV) dhe politika e bashkëpunimit me spektër të gjerë garanton realizimin e objektivave të programeve të studimeve.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof. As. Gafur Muka
2. PhD Elvan Dajko

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Universiteti POLIS ka plotësuar të gjitha rekomandimet të dhëna nga KA në vendimin për akreditimin e parë.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Objektivat dhe Programi i Studimit Bachelor në Studime Mjedisore, bazuar në Rregulloren e vetë programit dhe në vëzhgimin e programit, janë të hartuar/zhvilluar në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit, si dhe adresojnë kërkesat e tregut të punës.
2. Programi ofrohet nga një staf akademik i kualifikuar dhe i motivuar. Vlen të theksohet mbështetja që institucioni ofron për kualifikimin e mëtjshëm të stafit nëpërmjet programit të doktoraturës, por dhe nëpërmjet mundësisë për të diseminuar rezultatet e tyre kërkimore si: botimi i një periodiku shkencor me ISSN kombëtar e ndërkombëtar (Forum A+P), organizimit të aktiviteteve shkencore si konferenca, simpoziume, seminare (lokale dhe ndërkombëtare) si dhe grantit që i jepet departamenteve për të mbështetur financiarisht stafin për publikime ose pjesëmarrje në evente shkencore.
3. Programi ka një raport shumë të mirë staf/studentë (1:2) që i mundëson studentit të marrë vëmendje maksimale dhe të ndiqet nga afër nga stafi akademik.
4. Institucioni ka një infrastrukturë optimale në funksion të mirë-organizmit të programit. Krahas bibliotekës, duhet theksuar ngritja e një sërë laboratorësh të pajisura me aparatura dhe mjete bashkëkohore që plotësojnë në mënyrë ekselente kërkesat e programeve të studimit, e në vecanti Bachelor në Studime Mjedisore.
5. Universiteti POLIS ka ngritur një sistem shumë funksional për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Procedurat e vlerësimit janë të mirëpërcaktuara dhe periodike duke garantuar një monitorim të vazhdueshëm dhe efikas të cilësisë së programeve të ofruara nga institucioni. Vëmendja e treguar për ndërtimin e një kulture të cilësisë është reflektuar dhe në rezultatet e arritura gjatë proceseve të akreditimit institucional.
6. Programi është hartuar në zbatim të standardeve ligjore dhe përmban njohuri të përshtatshme për nivelin e studimeve dhe objektivat e programit. Këto dije përcillen tek studenti nëpërmjet metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies.
7. ~~Pas përfundimit të studimeve Bachelor në Studime Mjedisore evidentohet që një pjesë e mirë e studentëve integrohen në tregun e punës dhe pjesa tjetër vazhdon studimet Master.~~
8. Universiteti POLIS ka një aktivitet të pasur kërkimor ku bie në sy sasia dhe larmia e projekteve ndërkombëtare, gjë që ka influencuar pozitivisht jo vetëm institucionin por arsimin e lartë shqiptar në tërësi.

9. Institucioni bashkëpunon ngushtësisht me një rrjet të gjërë partnerësh vendas dhe të huaj për të gjitha fushat e veta të interesit, përfshi këtu dhe mjedisin. Këto bashkëpunime rezultojnë të vlefshme që institucioni të jetë i përditësuar me zhvillimet në fushën e mjedisit në vend dhe jashtë, për ti reflektuar ato në përmirësimin e kurrikulës, si dhe për të ofruar praktika lëndore e profesionale për studentët e këtij programi.

b. Pika të dobëta:

1. Numri relativisht i vogël i studentëve në hyrje (kryesisht në tre vitet e fundit) ndikon në mosshfrytëzimin me eficensën e duhur të kapaciteteve infrastrukturore, mësimore e shkencore që ofron institucioni edhe për programin e studimit Bachelor në Studime Mjedisore.

c. Mundësitë:

1. Rritja e kërkesës së tregut për ekspertë të mjedisit me një formim të shumëanshëm për të adresuar kompleksitetin në rritje të problemeve mjedisore.

2. Përmirësimi në vijimësi i kurrikulës dhe modernizimit i infrastrukturës në shërbim të mësimdhënies (kryesisht laboratorëve) do t'a bëjnë programin më konkurrues në treg.

3. Punësimi në masë akoma më të lartë i të diplomuarve të këtij programi studimi do të nxisë interesin e aplikantëve për të përzgjedhur të vazhdojnë studimet në të.

4. Rritja e bashkëpunimit me institucione të huaja partnere dhe e mobilitetit të studentëve do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e programit dhe pozicionimin e tij në treg.

d. Pengesat:

1. Numri jo shumë i lartë i të regjistruarve që pengon faktorizimin e programit dhe njohjen e tij në treg.

2. Profili shumë i spikatur i POLIS në fushën e Arkitekturës dhe Dizajnit, bën që institucioni të njihet kryesisht për këto disiplina, duke bërë që programet e tjera të mos marrin vëmendjen e duhur.

SUMMARY ANALYSIS OF THE STUDY PROGRAM EVALUATION

I. COMPREHENSIVE ANALYSIS OF THE FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

POLIS University has fulfilled all recommendations given from the AC in the first accreditation decision.

II. COMPREHENSIVE ANALYSIS OF EER ACCORDING TO THE SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS)

a. Strengths

1. The objectives and the Bachelor Study Program in Environmental Studies, based on the Program's own regulation and program monitoring, are designed / developed in accordance with the vision and mission of the institution, and address labor market requirements.

2. The program is provided by a qualified and motivated academic staff. It is worth mentioning the support that the institution offers for further qualification of staff through the doctoral program, but also through the possibility to disseminate their research results such as: publishing a scientific periodical with the national and international ISSN (Forum A + P), organizing the scientific activities such as (local and international) conferences, symposiums, seminars as well as grants awarded to departments to financially support staff for publications or participation in scientific events.
3. The program has a very good staff / student ratio (1: 2) that enables the student to get maximum attention and be closely followed by the academic staff.
4. The Institution has an optimal infrastructure in function of good organization of the program. In addition to the library, it is important to emphasize the establishment of a number of laboratories equipped with modern equipment and tools that meet excellently the requirements of study programs, and in particular the Bachelor in Environmental Studies.
5. POLIS University has established a very functional system for internal quality assurance. Evaluation procedures are well-defined and periodic, ensuring a continuous and effective monitoring of the quality of the programs provided by the institution. The attention shown to the building of a quality culture has been reflected in the results achieved during the institutional accreditation processes.
6. The program is drafted in compliance with legal standards and contains adequate knowledge of the level of studies and program objectives. This knowledge is forwarded to the student through contemporary teaching methodologies.
7. After completing Bachelor studies in Environmental Studies, it is evidenced that a good part of the students is integrated into the labor market and the rest continue to attend the Master studies.
8. POLIS University has a rich research activity, highlighting the quantity and variety of international projects, which has positively influenced not only the institution, but also the Albanian higher education as a whole.
9. The institution cooperates closely with a wide network of domestic and foreign partners in all its areas of interest, including the environment. These collaborations prove to be valuable for the institution to be up-to-date with developments in the field of the environment at home and abroad to reflect them on improving the curriculum and to provide subject and professional practices for the students of this program.

b. Weaknesses:

1. The relatively small number of students entering (mainly in the last three years) affects the lack of use of efficient infrastructure, teaching and scientific capacities provided by the institution for the Bachelor study program in Environmental Studies.

c. Opportunities:

1. Increase of market demand for environmental experts with a multidisciplinary education to address the increasing complexity of environmental problems.

2. The ongoing improvement of curricula and the modernization of infrastructure at the service of teaching (mainly laboratories) will make the program more competitive in the market.
3. Employment of graduates of this study program to a higher degree will stimulate the applicants' interest to select to continue their studies in it.
4. Increased cooperation with foreign partner institutions and student mobility will positively influence the quality of the program and its positioning in the market.

d. Threats:

1. The not very high number of enrolled students that hinders the factoring of the program and its recognition in the market.
2. POLIS's highly prominent profile in the field of Architecture and Design makes the institution familiar with these disciplines, making other programs not to get the proper attention.

The External Evaluation Group

3. Prof. As. Gafur Muka
4. PhD Elvan Dajko

